



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.109

14 gusht

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.459, datë 18.7.2007	Për kuotat kryesore të pranimit të studentëve në Universitetin Ushtarak “Skënderbej”, për vitin akademik 2007-2008.....	3149
Vendim i KM nr.464, datë 18.7.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Egnatia-Shushicë” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	3149
Vendim i KM nr.466, datë 18.7.2007	Për një ndryshim në vendimin nr.244, datë 7.3.2007 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e numrit të punonjësve, për vitin 2007, në ministritë dhe institucionet qendrore”	3150
Vendim i KM nr.467, datë 18.7.2007	Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave për kualifikimin, shkencor e pedagogjik, të personelit akademik.....	3150
Vendim i KM nr.481, datë 18.7.2007	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga rrëshqitja në segmentin rrugor Myc-Has	3156
Vendim i KM nr.483, datë 25.7.2007	Për përcaktimin e procedurave të kushteve dhe kriterëve për dhënien e statusit “Teatër metropolitan”	3160
Vendim i KM nr.484, datë 25.7.2007	Për caktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të bordit artistik të institucioneve publike qendrore të artit skenik.....	3161
Vendim i KM nr.486, datë 25.7.2007	Për ndërprerjen e veprimtarisë së përpunimit të anijeve, që transportojnë naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre, në portet e Durrësit dhe të Shëngjinit.....	3161
Vendim i KM nr.489, datë 25.7.2007	Për fondin e garantimit të kredive të eksportit.....	3164

Vendim i KM nr.492, datë 25.7.2007	Për dhënien e bursave për nxënësit e shkollës së mesme profesionale “Peter Mahringer”, Shkodër, për vitin shkollor 2007-2008.....	3166
Vendim i KM nr.493, datë 25.7.2007	Për përcaktimin e kushteve, të kriterëve dhe të masës së shpërblimit për rezultate të larta në artin skenik, të arritura në konkurrime ndërkombëtare.....	3166
Vendim i KM nr.494, datë 1.8.2007	Për miratimin e normave të trajtimit me ushqim të punonjësve të Policisë së Shtetit, të studentëve dhe kursantëve në shkollat e policisë dhe të shtetasve të ndaluar, deri në sqarimin e pozitës së tyre.....	3167
Udhëzim i MB nr.1150, datë 16.7.2007	Për procedurat e administrimit të donacioneve dhe financimin e projekteve	3168
Udhëzim i MB nr.1151, datë 16.7.2007	Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë së Brendshme.....	3171
Udhëzim i METE nr.548, datë 2.8.2007	Për shoqëritë anonime “në likuidim e sipër”, me kapital tërësisht shtetëror.....	3179
Udhëzim i MPPTT nr.16, datë 3.8.2007	Për një ndryshim në udhëzimin nr.994, datë 12.3.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e autoshkollave”, i ndryshuar.....	3181
Urdhër i MF nr.69, datë 17.7.2007	Për prodhimin, emetimin, administrimin dhe shitjen e policës kufitare të sigurimit.....	3181
Urdhër i MF nr.70, datë 20.7.2007	Për miratimin e primit të pastër të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta	3182

VENDIM
Nr.459, datë 18.7.2007

PËR KUOTAT KRYESORE TË PRANIMIT TË STUDENTËVE NË UNIVERSITETIN
USHTARAK “SKËNDERBEJ”, PËR VITIN AKADEMIK 2007-2008

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 31 e 35 të ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kuotat kryesore të pranimi në universitetin ushtarak “Skënderbej”, për vitin akademik 2007-2008, të jenë 150 (njëqind e pesëdhjetë) studentë, nga të cilët 15-20 për qind të jenë femra, si më poshtë vijon:

i) Fakulteti i Menaxhimit 90 (nëntëdhjetë) studentë;

ii) Fakulteti Teknik 60 (gjashtëdhjetë) studentë.

2. Kuota e pranimi për kursin pasuniversitar, për vitin akademik 2007-2008, të jetë 30 (tridhjetë) veta.

3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.464, datë 18.7.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME
KONCESION TË HIDROCENTRALIT “EGNATIA-SHUSHICË” DHE MIRATIMIN E
BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET
SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3 dhe 23, pika 3, shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të hidrocentralit “Egnatia-Shushicë”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 10 për qind të pikëve për rezultatin, teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese për zgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Vëllezërit TOLA” sh.p.k.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.466, datë 18.7.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.244, DATË 7.3.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE, PËR VITIN 2007, NË
MINISTRITË DHE INSTITUCIONET QENDRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet vendimit nr.244, datë 7.3.2007, të Këshillit të Ministrave, numrit të punonjësve buxhetorë, për vitin 2007, për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, (Policinë Elektrike), i shtohen 152 veta për periudhën 1 qershor-1 korrik 2007.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.467, datë 18.7.2007

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE PËR KUALIFIKIMIN,
SHKENCOR E PEDAGOGJIK, TË PERSONELIT AKADEMIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 47 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1.1 Sistemi i kualifikimit shkencor ka si qëllim përgatitjen e shkencëtarëve, të aftë për të konceptuar, organizuar, planifikuar dhe drejtuar studime e hulumtime, kërkimore-shkencore e pedagogjike të nivelit bashkëkohor.

1.2 Sistemi i kualifikimit shkencor përfshin studimet e doktoratës dhe kualifikimin, shkencor e pedagogjik, pas saj.

1.3 Universitetet që kanë të drejtë të promovojnë personelin akademik për titujt “Profesor i Asociuar” dhe “Profesor” janë:

- a) Universiteti i Tiranës;
- b) Universiteti Politeknik i Tiranës;
- c) Universiteti Bujqësor i Tiranës;
- ç) Akademia e Arteve të Bukura, Tiranë;
- d) Akademia e Kulturës Fizike dhe Sporteve, Tiranë;
- dh) Qendrat kërkimore-shkencore, me status të krahasueshëm me atë të një universiteti.

1.4 Të gjitha institucionet e arsimit të lartë publik kanë të drejtë të promovojnë personelin akademik, të punësuar me kohë të plotë, për titullin “Docent” dhe “Profesor emeritus”. Institucionet private të arsimit të lartë, të akredituara, kanë të drejtë të promovojnë personelin akademik, të punësuar në to, me kohë të plotë, për titullin “Docent”.

1.5 Për organizimin dhe drejtimin e kualifikimit, shkencor e pedagogjik, pas doktoratës, në fakultetet e institucioneve të arsimit të lartë ngrihet këshilli i profesorëve (KP). Në të bëjnë pjesë të gjithë profesorët, me kohë të plotë, të fakultetit. Numri minimal i profesorëve të KP-së duhet të jetë shtatë veta. Në rast se numri i profesorëve të fakultetit është më i vogël se shtatë, për të arritur këtë numër në KP mund të thirren profesorë të fushave të afërta, nga fakultetet e tjera, brenda universitetit, profesorë të ftuar apo profesorë me kontratë të fakultetit ose anëtarë, me titullin “Prof.Asoc.”, që janë në procesin e aplikimit për titullin “Profesor”.

Një profesor e drejton KP-në, me rotacion, për një vit akademik. Përbërja dhe funksionimi i KP-së rregullohen në përputhje me statutin dhe rregulloret e institucioneve të arsimit të lartë.

KREU II

KRITERET DHE PROCEDURAT PËR DHËNIEN E TITUJVE AKADEMIKË

2.1 Titulli “Docent”

2.1.1 Kriteret për dhënien e titullit “Doc.”

Titulli “Docent” (Doc.) u jepet anëtarëve të personelit akademik, të cilët përveç kriterëve bazë, të parashikuara në ligjin e arsimit të lartë (pika 6 e nenit 47), plotësojnë edhe kriteret e mëposhtme:

a) Kanë, së paku, një vit përvojë në mësimdhënie, në institucionet e arsimit të lartë, pas përfundimit të studimeve të doktoratës. Kandidatët, që kanë fituar gradën “Master të nivelit të dytë (MND)”, duhet të kenë, së paku, 5 vjet përvojë në mësimdhënie, në institucionet e arsimit të lartë;

b) Kanë përgatitur materiale mësimore (skripte, leksione, udhëzues praktikash ose ushtrimesh) për, së paku, një lëndë a modul;

c) Kanë realizuar, së paku, tri referime të shkurtra ose paraqitje (postera) në konferenca e kongrese shkencore, nga të cilat, së paku, një referim ose paraqitje duhet të jetë mbajtur në një veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), ku punimet janë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe janë botuar në “Proceedings”;

Bën përjashtim nga ky rregull personeli akademik i Akademisë së Arteve, krijues apo interpretues aktiv (kompozitorë, instrumentistë, këngëtarë, dirigjentë, aktorë, regjisorë, krijues të arteve pamore, koreografë, balerinë) që ka realizuar, së paku, tri koncerte recitale--premierë (vepra, ekspozita personale, vënie në skenë apo role kryesore) në veprimtari (festivale, sezone) dhe në salla të indeksuara, ndër të cilat, së paku, 1 të jetë realizuar jashtë Republikës së Shqipërisë, në një veprimtari ndërkombëtare (festival, sezon), ku vepra të jetë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak, të jetë botuar në katalogët/axhendat përkatëse dhe të jetë shoqëruar me kritikën përkatëse në shtypin profesional të indeksuar;

ç) Kanë botuar, së paku, dy artikuj shkencorë origjinalë ose review (analiza shkencore) në revista shkencore, nga të cilët, së paku, njëri duhet të jetë botuar ose pranuar për botim në një revistë shkencore të huaj, të njohur, me bord editorial.

Bën përjashtim nga ky rregull personeli akademik i Akademisë së Arteve, krijues apo interpretues aktiv (kompozitorë, instrumentistë, këngëtarë, dirigjentë, aktorë, regjisorë, krijues të arteve pamore, koreografë, balerinë), që ka marrë pjesë si solist, së paku, në dy realizime artistike (koncerte premierë, vepra, ekspozita personale, vënie në skenë apo role kryesore) në veprimtari (festivale, sezone), në bashkëpunim me trupa të shquara dhe në salla të indeksuara, ndër të cilët së paku, 1 të luajtur nga trupa ndërkombëtare (instrumentistë të shquar, ansamble të rëndësishme, orkestra dhe trupa operistike) në një veprimtari ndërkombëtare (festivale, sezone), ku performanca (vepra) të jetë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak, të jetë botuar në katalogët/axhendat përkatëse dhe të jetë shoqëruara me kritikën përkatëse në shtypin profesional të indeksuar.

2.1.2 Procedurat për dhënien e titullit “Doc.”

a) Promovimi për titullin “Docent” bëhet nga KP-ja e fakultetit, me kërkesë të kandidatit.

b) KP-ja dëgjon një leksion të hapur të kandidatit/es dhe vlerëson veprimtarinë kërkimore-mësimore të tij/saj. KP-ja merr vendim brenda 3 muajve nga paraqitja e kërkesës.

c) Kur vendimi është pozitiv, ajo i dërgon dekanit propozimin për dhënien e titullit “Docent”.

ç) Diploma “Docent”, pasi nënshkruhet nga dekani dhe rektori, vuloset me vulë të thatë dhe regjistrohet në regjistrin e institucionit të arsimit të lartë dhe në Ministri.

d) Kur vendimi i KP-së është negativ, kandidati ka të drejtë të riparaqesë kërkesën për të fituar

titullin “Docent”, jo më parë se 2 vjet, pas refuzimit të kërkesës së parë.

2.2 Titullin “Prof.Asoc.”

2.2.1 Kriteret për dhënien e titullit “Prof.Asoc.”

Titulli “Profesor i Asociuar” (Prof.Asoc.) u jepet anëtarëve të personelit akademik, të cilët kanë fituar gradën shkencore “Doktor” dhe përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) Kanë, së paku, tre vjet përvojë në mësimdhënie (së paku, pesë vjet për lektorët e ftuar) dhe gëzojnë aftësi të mirë mësimdhënëse. Titulli “Docent” nuk është parakusht për kërkimin e titullit “Prof.Asoc.”;

b) Kanë realizuar, pas doktoratës, së paku, 8 referime të shkurtra ose paraqitje (postera) në konferenca dhe kongrese shkencore, nga të cilat, së paku, pesë duhet të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres), ku punimet janë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe janë botuar në “Proceedings”;

Bën përjashtim nga ky rregull personeli akademik i Akademisë së Arteve, krijues apo interpretues aktiv (kompozitorë, instrumentistë, këngëtarë, dirigjentë, aktorë, regjisorë, krijues të arteve pamore, koreografë, balerinë), që ka realizuar së paku 4 koncerte recitale-premierë (vepra, ekspozita personale, vënie në skenë apo role kryesore) në veprimtari (festivale, sezone) dhe në salla të indeksuara, ndër të cilët, së paku, 1 të realizuar jashtë Republikës së Shqipërisë, në një veprimtari ndërkombëtare (festival, sezon), ku performanca (vepra) të jetë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak, të jetë botuar në katalogët/axhendat përkatëse dhe të jetë shoqëruar me kritikën përkatëse në shtypin profesional të indeksuar.

c) Kanë botuar, pas doktoratës, së paku, 5 artikuj shkencorë origjinalë ose review (analiza shkencore) në revista shkencore, nga të cilat, së paku, në 2 prej tyre si autor i parë, si dhe, së paku, 2 prej tyre të jenë botuar ose pranuar për botim në një revistë shkencore të huaj, të njohur, me bord editorial. Së paku, një artikull, duhet të jetë botuar në një revistë shkencore të huaj, me faktor impakti;

Bën përjashtim nga ky rregull personeli akademik i Akademisë së Arteve krijues apo interpretues aktiv (kompozitorë, instrumentistë, këngëtarë, dirigjentë, aktorë, regjisorë, krijues të arteve pamore, koreografë, balerinë), që ka marrë pjesë si i parë, së paku, në 4 realizime artistike (solist, vepra, ekspozita, vënie në skenë apo role kryesore) në veprimtari (festivale, sezone) të njohura, në bashkëpunim me trupa të shquara dhe në salla të indeksuara, ndër të cilët, së paku, 1 të luajtur nga trupa ndërkombëtare (instrumentistë të shquar, ansamble të rëndësishme, orkestra dhe trupa operistike) në një veprimtari ndërkombëtare (festivale, sezone), ku performanca (vepra) të jetë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak, të jetë botuar në katalogët/axhendat përkatëse dhe të jetë shoqëruar me kritikën përkatëse në shtypin profesional të indeksuar.

Një monografi shkencore, e botuar si autor i parë, në gjuhë të huaj, që mban numër ISBN-je, vlerësohet e barabartë me deri 6 artikuj shkencorë. Një monografi shkencore, e botuar si autor i parë, në gjuhën shqipe që mban numër ISBN-je, vlerësohet e barabartë me deri 4 artikuj shkencorë, të botuar brenda vendit.

Për personelin akademik të Akademisë së Arteve një koncert recital, i luajtur jashtë Republikës së Shqipërisë në veprimtari (festivale, sezone) të njohura, në bashkëpunim me trupa të shquara dhe në salla të indeksuara, vlerësohet i barabartë me deri 3 pjesëmarrje nëpër koncerte, me të njëjtat kushte. Një koncert recital-premierë brenda Republikës së Shqipërisë në veprimtari (festivale, sezone) të njohura, në bashkëpunim me trupa të shquara dhe në salla të indeksuara, vlerësohet i barabartë me deri në 2 pjesëmarrje nëpër koncerte, me të njëjtat kushte;

ç) Kanë qenë titullarë, së paku, të një lënde a moduli për më shumë se dy vite akademike dhe kanë përgatitur materiale mësimore, në formë skriptesh, cikël leksionesh, udhëzues praktikash ose ushtrimesh.

2.2.2 Procedurat për dhënien e titullit “Prof.Asoc.”

Promovimi për titullin “Prof.Asoc.” bëhet nga KP-të e fakulteteve, të universiteteve të përmendura në pikën 1.3 me kërkesë të vetë kandidatit/es. Kandidatët që punojnë me kohë të plotë, pranë institucioneve të arsimit të lartë, të cilët nuk përfshihen në pikën 1.3, dorëzojnë dosjen në KP-në e fakultetit të tyre. Brenda një muaji KP-ja jep mendim për fillimin e procedurës së vlerësimit të kandidatit/es dhe ia përcjell dosjen universitetit dhe fakultetit të fushës, që gëzon të drejtën e promovimit për titullin “Prof.Asoc.”, siç përcaktohet në pikën 1.3, së bashku me mendimin për fillimin e procedurave të vlerësimit të kandidatit.

Shqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesës për titullin “Prof.Asoc.” bëhet sipas kësaj procedure:

a) Brenda një muaji, KP-ja vlerëson nëse dosja është e plotë dhe ngre komisionin vlerësues (KV), i cili përbëhet nga 7 anëtarë, që kanë titullin “Profesor”. Së paku, katër anëtarë të KV-së duhet të jenë nga jashtë universitetit dhe, së paku, dy anëtarë duhet të jenë profesorë të shkencave teorike bazë. Në përbërje të KV-së mund të jetë edhe një profesor i fushës ose i një fushe të afërt, nga universitetet e huaja. Në këtë rast kandidatit/es i kërkohet që dosjen dhe referatin e hapur, t’i paraqesë edhe në një gjuhë të huaj, që ai/ajo zotëron dhe që është e përshtatshme për anëtarët e KV-së;

b) Brenda tre muajve, komisioni i vlerësimit vlerëson aftësitë pedagogjike-didaktike të kandidatit/es. KV-ja merr pjesë, së paku në 3 seanca mësimore dhe e fton kandidatin/en në një referat të hapur shkencor;

c) Komisioni vlerësues harton një raport përfundimtar vlerësues për veprimtarinë botuese dhe aftësitë pedagogjike të kandidatit/es, të cilin ia paraqet KP-së, së bashku me rekomandimin për dhënien ose jo të titullit;

ç) KP-ja zyrtarizon rekomandimin e KV-së. Në rast se kërkesa e kandidatit/es nuk miratohet, ai/ajo ka të drejtë të riparaqesë kërkesën jo më parë se dy vjet, pas refuzimit të kërkesës së parë;

d) Dekani i fakultetit organizon një leksion të hapur përurues, ku i dorëzohet kandidatit/es diploma “Prof.Asoc.”.

Diploma “Prof.Asoc.” nënshkruhet nga dekani e rektori, vuloset me vulë të thatë dhe regjistrohet në regjistrin e universitetit dhe në ministri.

2.3 Titulli “Prof.”

2.3.1 Kriteret për dhënien e titullit “Prof.”

Titulli “Profesor” (Prof.) u jepet anëtarëve të personelit akademik, që kanë fituar gradën shkencore “Doktor” dhe përmbushin kriteret e mëposhtme:

a) Kanë së paku, pesë vjet përvojë në mësimdhënie (së paku shtatë vjet për lektorët me kohë të pjesshme), pas marrjes së gradës shkencore “Doktor”. Titujt “Docent” dhe “Prof.Asoc.” nuk janë parakusht për kërkimin e titullit “Profesor”;

b) Gëzojnë aftësi të mira mësimdhënëse dhe kanë marrë pjesë aktive në zhvillimin, akademik dhe institucional, të institucioneve të arsimit të lartë;

c) Kanë pasur një përvojë kërkimore ose mësimdhënëse prej, së paku, një viti, në një institucion kërkimor-mësimor, jashtë vendit. Përvoja të tilla vlerësohen, kur qëndrimet në institucionet homologe jashtë shtetit kanë qenë pa ndërprerje ose edhe me ndërprerje.

Në rastin e personelit akademik të Akademisë së Arteve mund të llogariten edhe drejtimi i *masterclass*-ave apo *workshop*-eve ndërkombëtare;

ç) Janë në gjendje të mbajnë, në nivel të kënaqshëm, leksione të veçanta ose cikle leksionesh, në njërën nga këto gjuhë të huaja: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht dhe rusisht;

d) Kanë realizuar si autorë të parë, pas marrjes së gradës “Doktor”, së paku, 15 referime të shkurtër ose paraqitje (postera) në konferenca dhe kongrese shkencore, nga të cilat, së paku, 8 duhet të jenë mbajtur në një veprimtari shkencore ndërkombëtare (simpozium, konferencë, kongres) ku punimet janë pranuar, në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe janë botuar në “Proceedings”.

Bën përjashtim nga ky rregull personeli akademik i Akademisë së Arteve krijues apo interpretues aktiv (kompozitorë, instrumentistë, këngëtarë, dirigjentë, aktorë, regjisorë, krijues të arteve pamore, koreografë, balerinë), që ka realizuar pas marrjes së titullit “Prof.Asoc.”, së paku 6 koncerte recitale-premierë (vepra, ekspozita personale, vënie në skenë apo role kryesore) në veprimtari (festivale, sezone) dhe në salla të indeksuara, ndër të cilët, së paku, 2 të realizuara jashtë Republikës së Shqipërisë në një veprimtari ndërkombëtare (festival, sezon), ku performanca (vepra) të jetë pranuar, në bazë të një vlerësimi paraprak, të jetë botuar në katalogët/axhendat përkatëse dhe të jetë shoqëruar me kritikën përkatëse, në shtypin profesional të indeksuar.

dh) Kanë botuar, pas marrjes së gradës “Doktor”, së paku, 9 artikuj shkencorë origjinalë ose review (analiza shkencore) në revista shkencore, nga të cilët 4 si autorë të parë, si dhe, së paku, 4 prej tyre duhet të jenë botuar ose pranuar për botim në një revistë shkencore të huaj, të njohur me bord editorial. Së paku, dy artikuj duhet të jenë botuar në një revistë shkencore të huaj, me faktor impakti.

Bën përjashtim nga ky rregull personeli akademik i Akademisë së Arteve, krijues apo interpretues aktiv (kompozitorë, instrumentistë, këngëtarë, dirigjentë, aktorë, regjisorë, krijues të arteve pamore, koreografë, balerinë), që ka marrë pjesë si i parë, së paku në 7 realizime artistike (solist, vepra, ekspozita, vënie në skenë apo role kryesore) në veprimtari (festivale, sezone) të njohura, në bashkëpunim me trupa të shquara dhe në salla të indeksuara, ndër të cilat, së paku, 3 të luajtura nga

trupa ndërkombëtare (instrumentistë të shquar, ansamble të rëndësishme, orkestra dhe trupa operistike) në një veprimtari ndërkombëtare (festivale, sezone) ku performanca (vepra) të jetë pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak, të jetë botuar në katalogët/axhendat përkatëse dhe të jetë shoqëruar me kritikën përkatëse, në shtypin profesional të indeksuar.

Një monografi shkencore e botuar, si autor i parë, në gjuhë të huaj, që mban numër ISBN-je, vlerësohet e barabartë me deri gjashtë artikuj shkencorë. Një monografi shkencore, e botuar, si autor i parë, në gjuhën shqipe, që mban numër ISBN-je, vlerësohet e barabartë me deri katër artikuj shkencorë, të botuar brenda vendit.

Për personelin akademik të Akademisë së Arteve një koncert-recital, i luajtur jashtë Republikës së Shqipërisë, në veprimtari (festivale, sezone) të njohura, në bashkëpunim me trupa të shquara dhe në salla të indeksuara, vlerësohet i barabartë me deri 3 pjesëmarrje nëpër koncerte, me të njëjta kushte. Një koncert recital-premierë, brenda Republikës së Shqipërisë, në veprimtari (festivale, sezone) të njohura, në bashkëpunim me trupa të shquara dhe në salla të indeksuara, vlerësohet i barabartë me deri 2 pjesëmarrje nëpër koncerte, me të njëjtat kushte.

e) Kanë qenë titullar, së paku, të një lënde a moduli për më shumë se katër vite akademike dhe kanë përgatitur materiale mësimore, në formë skriptesh, leksionesh, udhëzues praktikash ose ushtrimesh për programin mësimor të dy ose më shumë lëndëve a moduleve, njëra prej të cilave në ciklin e dytë të studimeve “Master”.

2.3.2 Procedura për dhënien e titullit “Prof.”

a) Promovimi për titullin “Prof.” bëhet nga KP-ja e fakulteteve të shkollave të larta, të përmendura në pikën 1.3 të këtij vendimi, me kërkesë të kandidatit/es. Kandidatët, që punojnë me kohë të plotë, pranë institucioneve të arsimit të lartë, të cilët nuk përfshihen në pikën 1.3, dorëzojnë dosjen në KP-në e fakultetit të tyre. Brenda një muaji, KP-ja jep mendim për fillimin e procedurës së vlerësimit të kandidatit/es dhe ia përcjell dosjen shkollës së lartë dhe fakultetit të fushës, që gëzon të drejtën e promovimit për titullin “Prof.”, siç përcaktohet në pikën 1.3.

b) Brenda një muaji, KP-ja verifikon nëse dosja është e plotë dhe ia përcjell atë senatit të shkollës së lartë, së bashku me propozimin për përbërjen e komisionit vlerësues (KV). Ky komision përbëhet nga 7 anëtarë, të cilët duhet të kenë titullin “Prof.”. Së paku, pesë anëtarë të KV-së duhet të jenë jashtë universitetit, nga vjen kandidati/ja dhe, së paku, dy anëtarë të KV-së duhet të jenë profesor të shkencave teorike bazë. Në përbërje të KV-së mund të jetë edhe një profesor i fushës ose i një fushe të afërt, nga universitetet e huaja. Në këtë rast kandidatit/es i kërkohet, që dosjen dhe referatin e hapur ta paraqesë edhe në një gjuhë të huaj, që ai zotëron dhe që është e përshtatshme për anëtarët e KV-së;

c) Brenda një muaji, senati e shqyrton kërkesën dhe merr vendim për t’i propozuar Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë komisionin vlerësues;

ç) Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë shqyrton, brenda dy muajve, kërkesën e senatit, miraton komisionin vlerësues dhe merr vendim për fillimin e vlerësimit pedagogjik të kandidatit. Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë gëzon të drejtën, kur e gjykon të nevojshme, të kërkojë vlerësime, me shkrim, nga profesorë të huaj ose marrjen pjesë në komisionin e vlerësimit të një ose dy profesorëve të huaj;

d) Brenda tri muajve komisioni i vlerësimit vlerëson aftësitë pedagogjike-didaktike të kandidatit/es. Komisioni i vlerësimit merr pjesë, së paku, në 3 seanca mësimore dhe e fton kandidatin/en në një referat të hapur shkencor. Një pjesë të referatit kandidati/ja e paraqet në një gjuhë të huaj, që zotëron;

dh) Komisioni vlerësues harton një raport përfundimtar vlerësues për veprimtarinë botuese dhe aftësitë pedagogjike të kandidatit/es, të cilin ia paraqet Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë, së bashku me rekomandimin për dhënien ose jo të titullit;

e) Brenda dy muajve, Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë shqyrton raportin e komisionit vlerësues dhe merr vendim për dhënie ose jo të titullit “Prof.”. Kur vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë është negativ, kandidati i jepen argumentet përkatëse. Kandidati ka të drejtë të rifillojë procedurën jo më parë se dy vjet nga data e refuzimit të kërkesës së parë;

ë) Diploma e titullit “Prof.” nënshkruhet nga Ministri dhe regjistrohet në regjistrin e Komisionit të Vlerësimit të titujve Akademikë;

f) Rektori i universitetit i dorëzon kandidatit/es fitues diplomën e titullit “Prof.” në një ceremoni, leksion përurues të profesurës.

2.4 Titulli “Akademik” është titulli, që fiton çdo profesor, i cili është pranuar anëtar i

Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë. Në rastin kur ai/ajo është profesor në institucionin e arsimit të lartë, gëzon të gjitha atributet që i takojnë titullit “Akademik”.

2.5 Titulli “Profesor emeritus” (Prof.emeritus) është titull, që u jepet profesorëve më të suksesshëm, kur arrijnë moshën e pensionit, sipas kriterëve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Profesorëve emeritus u jepet mjedis pune në departament, si dhe mund të thirren për leksione të veçanta ose të përfshihen në grupe pune apo komisione. Atyre u jepet një shpërblim mbi pension, masa e të cilit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2.6 Titulli “Doctor honoris causa” u jepet figurave të shquara të shkencës dhe shoqërisë, për kontribut të veçantë në zhvillimin e arsimit dhe të shkencës, si dhe në zhvillimin, në tërësi të vendit tonë. Ky titull jepet nga institucionet e arsimit të lartë, pasi të jetë marrë pëlqimi i Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë.

KREU III DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

3.1 Të gjitha kërkesat për titujt “Prof.Asoc.” dhe “Prof.”, që kanë hyrë në sekretarinë e Komisionit të Kualifikimit Shkencor deri më 1.7.2007 dhe që nuk janë diskutuar, shqyrtohen nga Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë, në përputhje me vendimin nr.786, datë 17.12.1998 të Këshillit të Ministrave “Për kualifikimin shkencor pasuniversitar dhe për klasifikimin e punonjësve, pedagogjikë e kërkimorë”, të ndryshuar.

3.2 Të gjitha kërkesat për titujt “Prof.Asoc.” dhe “Prof.”, që janë miratuar në departamentet e institucioneve të arsimit të lartë përpara datës 1.7.2007, por nuk kanë hyrë në sekretarinë e Komisionit të Kualifikimit Shkencor deri më 1.7.2007, shqyrtohen në bazë të kriterëve të parashikuara në vendimin nr.786, datë 17.12.1998 të Këshillit të Ministrave “Për kualifikimin shkencor pasuniversitar dhe për klasifikimin e punonjësve, pedagogjikë e kërkimorë”, të ndryshuar, ndërsa procedurat do të zbatohen në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.

3.3 Shqyrtimi i dosjeve për titullin “Doctor honoris causa”, të mbërritura në Komisionin e Vlerësimit të Titujve Akademikë deri më 1.7.2007, bëhet në bazë të vendimit nr.786, datë 17.12.1998 të Këshillit të Ministrave “Për kualifikimin shkencor pasuniversitar dhe për klasifikimin e punonjësve, pedagogjikë e kërkimorë”, të ndryshuar.

3.4 Afatet e përcaktuara për procedurat e dhënies së gradave dhe të titujve akademikë, brenda institucioneve të arsimit të lartë, u referohen vitit akademik.

3.5 Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë vlerëson dhe njehson titujt akademikë, të fituar jashtë shtetit, të barasvlefshëm me titullin akademik “Prof.”. Në këto raste, për titullin nuk lëshohet diplomë e re, por mjafton një regjistrim pranë këtij komisioni.

3.6 Titujt akademikë, të fituar jashtë shtetit, të barasvlefshëm me titullin akademik “Prof.Asoc.”, vlerësohen dhe njehsohen nga universitetet, në përputhje me pikën 1.3 të këtij vendimi. Në këto raste për titullin nuk lëshohet diplomë e re, por mjafton një regjistrim pranë institucioneve të arsimit të lartë.

3.7 Vendimi nr.786, datë 17.12.1998 i Këshillit të Ministrave “Për kualifikimin shkencor pasuniversitar dhe për klasifikimin e punonjësve, pedagogjikë e kërkimorë”, i ndryshuar, si dhe aktet e tjera nënligjore, të dala në zbatim të tij, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.481, datë 18.7.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA RRËSHQITJA NË
SEGMENTIN RRUGOR MYC-HAS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rrëshqitja në segmentin rrugor Myc-Has.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 846 m², tokë/arë, të vlerësuar me 300 lekë/m², me vlerë totale prej 253 800 (dyqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëqind) lekësh, kultura bujqësore, me vlerë 8 273 (tetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e tre) lekë, me një vlerë të përgjithshme 262 073 (dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëdhjetë e tre) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në shumën 238 500 (dyqind e tridhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 262 073 (dyqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëdhjetë e tre) lekë, të përballohet nga llogaria speciale e krijuar si transfertë kapitale për t’u përdorur për shpronësimet.
 6. Shpronësimi të fillojë më 20.7.2007 dhe të përfundojë më 20.8.2007.
 7. Pronarët e përcaktuar në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Plotësim dokumentacioni”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë, të pronësisë, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha


**LISTA E PRONAREVE TE CILET SHPRONESOHEN SI REZULTAT I RRESHQITJES SE NDODHUR NE SEGMENTIN
RRUGOR MYC - HAS**

Nr	Emri	Zk.	Nr. Pas	Sip. m2	Cmimi Tokës Arë Lekë/m2	Vlera Lekë	Jonxhë Lekë/m 2	Vlera Lekë	Totali	Shënime
1	Sadik Ibrahim Bytyci	2760	99	35	300	10 500	9.78	342	10 842	Plotësim dokumentacioni
2	Beqir Selim Bytyci	2760	95	177	300	53 100	9.78	1731	54 831	Plotësim dokumentacioni
3	Qerim Brahim Bytyci	2760	84	386	300	115 800	9.78	3775	119 575	Plotësim dokumentacioni
4	Medi Halil Bytyci	2760	86	85	300	25 500	9.78	831	26 331	Plotësim dokumentacioni
5	Mal Halil Bytyci	2760	87	85	300	25 500	9.78	831	26 331	Plotësim dokumentacioni
6	Abdyl Arif Bytyci	2760	236	78	300	23 400	9.78	763	24 163	Plotësim dokumentacioni
	Totali			846		253 800		8 273	262 073	

PLANIMETRIA SH. 1-500
(MASAT INXHINIERIKE)

ODJELCI: MASA INŽINERISKE P. ARIZ-0-MALI-KRUM	Faza
	PROJEKT-ZBATIM
ZONA MUČAS	7-7
PROJEKTORES: GLEBOLLOV	<i>Glebov</i>
INVIJ. PAUJTM STRUGA INVIJ. LILI DHANE	
SUBJEKTI	Febru. 1972 DIREKTOR 2004
FRMA KONSULENTE "SAEI", TIRANË	

1. AKSI I PIKETUAR PËRFAQSON ANËN E MAJTE
TE RUGES TË DREJTIMIT KRUMË-KUKËS.
2. SPOTIMET I AKSIT TË PIKETUAR REALIZOHET
KESHË : NE P.K O AKSI I PIKETUAR SPOTIHOHET
3.5m (KRUIHET VERTIKSIAL VJ) DHE KJO
PIKE BASHKOHET ME P.K 7. NGA NDERPËRJEJA
E KETË DREJTIMI MEATE TË RUGES ENKIZIST
NE VAZHDM DO TE KRUIHET VERTEKSI
TJETËR VZ.
3. SPOTIMET NE 500 PIKETE JEPEN NE
PROFILAT TËRTHORE,
3. TOMBINO EZK. P.K 2 DO TE PRISHET



VENDIM
Nr.483, datë 25.7.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË KUSHTEVE DHE KRITEREVE PËR
DHËNIEN E STATUSIT “TEATËR METROPOLITAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 30 të ligjit nr.9631, datë 30.10.2006 “Për artin skenik”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e statusit të veçantë “Teatër metropolitan”, në kuptim të nenit 30 të ligjit nr.9631, datë 30.10.2006 “Për artin skenik”, me urdhër të Kryeministrit, pas propozimit të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, një institucioni të artit skenik vendor, që plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuar në këtë vendim.

2. Procedurat për të fituar statusin “Teatër metropolitan”, janë si, më poshtë vijon:

a) Paraqitja e kërkesës, së bashku me dokumentacionin e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, dhe me një historik të veprimtarisë së institucionit të artit skenik vendor, te Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore, ku ka selinë ky institucion.

b) Shqyrtimi i kërkesës dhe i dokumentacionit shoqërues nga struktura përkatëse e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, e cila pasi verifikon nëse institucioni plotëson kushtet dhe kriteret e përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi dhe vërtetësinë e dokumentacionit, i paraqet një raport, me shkrim, Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, ku shprehet për përfitimin ose jo të këtij statusi.

Afati nga depozitimi i kërkesës deri në shqyrtimin përfundimtar të saj është 45 ditë.

c) Nëse kërkesa miratohet, Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve i propozon Kryeministrit dhënien e statusit të veçantë “Teatër metropolitan”.

3. Kushtet dhe kriteret, që duhet të plotësojë një institucion publik i artit skenik vendor për përfitimin e statusit të veçantë “Teatër metropolitan”, janë si më poshtë vijon:

a) Të ketë zhvilluar veprimtari artistike si teatër profesionist, për jo më pak se 55 vjet.

b) Të ketë fituar titullin më të lartë ose njërin nga tri çmimet e para të festivalit kombëtar.

c) Të ketë marrë pjesë në veprimtari ndërkombëtare dhe të jetë vlerësuar me çmime.

ç) Të ketë shfaqur mbi 200 premiera.

d) Qarku ku e ka selinë teatri të ketë jo më pak se 300 000 banorë.

4. Ngarkohet Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.484, datë 25.7.2007

**PËR CAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË BORDIT ARTISTIK
TË INSTITUCIONEVE PUBLIKE QENDRORE TË ARTIT SKENIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10, pika 6, e 18, pika 6, të ligjit nr.9631, datë 30.10.2006 “Për artit skenik”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Anëtarët e bordit artistik të institucioneve publike qendrore të artit skenik të shpërblehen në masën 5 000 (pesë mijë) lekë, për çdo pjesëmarrje në mbledhje.
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet buxhetore të institucioneve publike qendrore të artit skenik, pranë të cilave funksionon ky bord.
3. Ngarkohen institucionet publike qendrore të artit skenik për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.486, datë 25.7.2007

**PËR NDËRPRERJEN E VEPRIMTARISË SË PËRPUNIMIT TË ANIJEVE, QË
TRANSPORTOJNË NAFTË, GAZ DHE NËNPRODUKTE TË TYRE, NË PORTET E
DURRËSIT DHE TË SHËNGJINIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 2 të ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndërprerjen e veprimtarisë së përpunimit të anijeve, që transportojnë naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre, në portet e Durrësit dhe të Shëngjinit, brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.
2. Veprimtaria e përpunimit të anijeve, që transportojnë naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre, të vazhdojë të kryhet në portet e tjera, të miratuara për këtë qëllim.
3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPERISE

MINISTRIA E EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HIDROKARBUREVE

Leje tregtimi

Bazuar në VKM Nr.704, Datë 21.12.2000

Nr. 47 datë 5 Janar 2001

Në mbështetje të ligjit Nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin transportin dhe tregëtimin e Naftës, Gazit dhe nënprodukteve të tyre" dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.704 dt.21.12.2000.

I jepet Shoqërisë Anonime: "GLOBAL PETROLEUM ALBANIA"

me seli: Rr "Deshmoret e 4 Shkurtit", P.7, Sh.1, Ap.16, Tiranë

Kjo leje është e llojit "A"

Për kategorinë e "II"(A), "III"(A), "III"(B) "IV"(A)

E vlefshme për një periudhë deri 18 muaj pas daljes së Vendimit për
çvendosjen e depozitave në portin e Durrësit, por jo më shumë se 10 vjet.

MINISTRI

Mustafa MUÇI

Nr.24/ prot.,dt. 5 Janar 2001

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E HIDROKARBUREVE

Leje tregtimi

Bazuar në VKM Nr. 704, Datë 21.12.2000

Nr. 54 datë 16.03.2001

Në mbështetje të ligjit Nr. 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin transportin dhe tregëtimin e Naftës, Gazit dhe nënprodukteve të tyre" dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 704 dt. 21.12.2000.

I jepet Shoqërisë Anonime: "EVROIL"

me seli: Rruga e Portit, Durrës

Kjo leje është e llojit "A"

Për kategorinë e "II"(A,C), "III"(A,B), "IV"(A)

E vlefshme për një periudhë deri 18 muaj pas daljes së Vendimit për çvendosjen e depozitave në portin e Durrësit, por jo më shumë se 10 vjet.

MINISTRI


Mustafa MUÇI

Nr. 862/ ¹³ prot., dt. 16.03.2001

VENDIM
Nr.489, datë 25.7.2007

PËR FONDIN E GARANTIMIT TË KREDIVE TË EKSPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 8 e 15 të ligjit nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme” dhe të nenit 38 të ligjit nr.9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e një fondi limit, brenda të cilit të lëshohen garanci për kredite e eksportit (më poshtë FGKE). Ky fond është pjesë e garancive, që lëshon shteti, dhe kufiri maksimal i tyre, që do të lëshohen në vitin 2007, të jetë në shumën 200 000 000 (dyqind milionë) lekë, i cili do të vazhdojë të përdoret për një periudhë kohore prej 6 vjetësh.

2. Fondi i garantimit të kredive të eksportit do të përdoret për të mbuluar kërkesat për kolateral për kredi tregtare, për mjete xhiroje për ndërmarrjet, të kërkuara nga sistemi bankar shqiptar, në bazë të rregullave të mbikëqyrjes bankare, të vendosura nga Banka e Shqipërisë.

3. Përfitojnë nga FGKE-ja ndërmarrjet, e vogla dhe të mesme, që ushtrojnë veprimtari në prodhimin për eksport. Si të tilla vlerësohen ndërmarrjet, që dërgojnë mallra jashtë vendit, për tregtim apo shitje, si dhe ndërmarrjet, që ofrojnë shërbime për blerësit e huaj.

4. Nuk përfitojnë nga FGKE-ja ndërmarrjet, që e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në sektorët e mëposhtëm:

- Lojërat e fatit;
- Prodhim dhe tregtim të duhanit;
- Prodhim dhe tregtim të armëve.

5. Ministria e Financave ushtron të drejtën për lëshimin e garancive për kredite e eksportit nëpërmjet Komitetit të Vlerësimit dhe Miratimit të Garancive, i cili do të krijohet pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, dhe njoftimit nga Ministria e Financave për përfshirjen e limitit të garancive të kredisë për eksport në fondin e garancive shtetërore.

6. Albinvest do të luaj rol in e sekretarisë teknike të Komitetit të Vlerësimit dhe Miratimit të Garancive dhe do të përgjigjet për përmbushjen e kushteve të dhënies së garancive nga ndërmarrjet përfituese.

7. Komiteti i Vlerësimit dhe Miratimit të Garancive kryesohet nga zëvendësministri i Financave dhe në përbërje ka:

- | | |
|---|------------|
| a) Zëvendësministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës | nënkryetar |
| b) Këshilltarin e Kryeministrit për ekonominë | anëtar; |
| c) Një përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit, në Ministrinë e Financave, | anëtar; |
| ç) Një përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës | anëtar; |
| d) Një përfaqësues të Bankës së Shqipërisë | anëtar; |
| dh) Një përfaqësues të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare | anëtar. |

8. Drejtori Ekzekutiv i Albinvest-it, mbështetur në vendimin e Komitetit të Vlerësimit dhe Miratimit të Garancive, nënshkruan, rast pas rasti, marrëveshjet e garancisë me bankat, që kreditojnë ndërmarrjet eksportuese. Garancia lëshohet për një periudhë jo më të gjatë se 12 muaj dhe mbulon deri në 85 përqind të shumës së kredisë, që kërkohet të garantohet.

9. Një ndërmarrje eksportuese për një transaksion të veçantë mund të përfitojë mbulimin e nevojave për kolateral, për marrje kredie bankare për kapital punues, për një shumë deri në 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë ose ekuivalentin e kësaj shume, në çdo monedhë të huaj, të konvertueshme, me të cilën jepet kredia bankare. Për çdo garanci të lëshuar, ndërmarrja përfituese do të paguajë një komision, që përcaktohet dhe bëhet publik nga Komiteti i Vlerësimit dhe Miratimit të Garancive.

10. Ndërmarrja përfituese mund të aplikojë për garanci më shumë se një herë, brenda vitit, por

kohëzgjatja e të gjitha aplikimeve nuk duhet të kalojë 12 muaj dhe shuma e garancive të dhëna, për të gjitha aplikimet e bëra brenda vitit, të marra së bashku, nuk duhet të jetë më e madhe se 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekë.

11. Ndërmarrjet përfituese i bëjnë kërkesë për lëshim garancie, nëpërmjet FGKE-së Albinvest-it, i cili pasi i shqyrton dhe i vlerëson, ia paraqet Komitetit të Vlerësimit dhe Miratimit të Garancive, vetëm nëse ndërmarrjet përfituese plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- Janë të regjistruara në organet tatimore dhe kanë paguar rregullisht tatimet dhe kontributin e sigurimeve shoqërore;

- Kanë aplikuar për kredi për kapital punues në një bankë të nivelit të dytë dhe paraqesin vendimin e miratimit nga banka, ku jepet saktë shuma e kolateralit të kërkuar;

- Kanë rezultuar, gjatë tri viteve të fundit, me fitim dhe xhiroja e tyre ka qenë në rritje;

- Kanë një parashikim të rrjedhjes për tri vitet e ardhshme, i cili garanton shlyerjen e kredisë së kërkuar;

- Pronarët, aksionarët, anëtarët e bordit dhe drejtuesit e ndërmarrjes përfituese nuk zotërojnë paketën kontrolluese në bankat, ku aplikojnë për kredi, nuk kanë qenë kreditorë në firmat piramidale dhe nuk janë dënuar asnjëherë për vepra penale, që lidhen me administrimin e vlerave, materiale e monetare.

12. Komiteti i Vlerësimit dhe Miratimit të Garancive merr vendimet për lëshimin e garancive, në bazë të propozimit të Albinvest-it, i cili shoqërohet me një vlerësim ekonomiko-financiar dhe të risqeve, të kryera nga Albinvest për secilën ndërmarrje, që kërkon lëshimin e garancisë.

13. Albinvest-i, në bazë të vendimit të Komitetit të Vlerësimit dhe Miratimit të Garancive, njofton bankat për garancitë e lëshuara, dhe, pas bërjes efektive të garancive, njofton Ministrinë e Financave, e cila bën regjistrimin e tyre.

14. Bankat njoftojnë, çdo muaj, Albinvest-in për marrëdhëniet me huamarrësit, që kanë marrë garanci nga FGKE-ja. Albinvest-i përgatit një raport për Ministrin e Financave dhe Ministrin e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

15. Bankat kërkojnë zbatimin e garancisë vetëm pasi kanë provuar zbatimin e të gjitha procedurave të tyre për vjeljen e kredive dhe u ka lindur e drejta për ekzekutimin e kolateralit, që, në këtë rast, është garancia e lëshuar nga Komiteti i Vlerësimit dhe Miratimit të Garancive. Kërkesa për ekzekutim i bëhet Albinvest-it dhe miratimi i ekzekutimit të garancisë bëhet nga Komiteti i Vlerësimit dhe Miratimit të Garancive. Ministria e Financave, në bazë të këtij vendimi, bën pagesën në favor të bankës, që kishte dhënë kredi.

16. Pas kryerjes së pagesës, Albinvest-i ndërmerr hapat ligjore për të bërë të mundur kthimin, në buxhet, nga huamarrësi, të shumës, që i është paguar huadhënësit nga Ministria e Financave për garancinë e lëshuar.

17. Ministri i Financave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës miratojnë rregulloren e funksionimit të FGKE-së ku përcaktohen marrëdhëniet me bankat kredituese, procedurat dhe formularët e kërkesës për garanci, kriteret për përzgjedhjen e përfituesve, si dhe kushtet e termat specifike, që duhet të plotësojnë ndërmarrjet, që të përfitojnë nga ky fond.

18. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.492, datë 25.7.2007

PËR DHËNIEN E BURSIVE PËR NXËNËSIT E SHKOLLËS SË MESME PROFESIONALE
“PETER MAHRINGER”, SHKODËR, PËR VITIN SHKOLLOR 2007-2008

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të ligjit nr.9522, datë 25.4.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës

së Austrisë, për bashkëpunimin në fushat e kulturës, të arsimit dhe shkencës”, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Ministria e Arsimit dhe Shkencës të japë 30 bursa studimi, për nxënësit e viteve të para, të shkollës së mesme profesionale “Peter Mahringer”, Shkodër, për vitin shkollor 2007-2008.

2. Masa e bursës të jetë 680 euro për nxënës në vit, për shlyerjen e tarifës mujore të shkollimit dhe mbulimin e kostos së teksteve mësimore.

3. Buxheti për mbulimin e këtyre bursave t’i kalojë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës drejtorisë arsimore rajonale, Shkodër.

4. Miratimi i këtyre bursave bëhet nga bordi i fondacionit shkollor austriak, në mbështetje të kriterëve ekonomike dhe të rezultateve të arritura nga secili nxënës/aplikant.

5. Bordi i fondacionit shkollor austriak, pas miratimit të bursave, dërgon dokumentacionin përkatës në drejtorinë arsimore rajonale, Shkodër, e cila, pas konfirmimit të nxënësve, që përfitojnë bursë, e kalon masën e bursës në llogarinë personale të secilit nxënës.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor, i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.493, datë 25.7.2007

**PËR PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE, TË KRITEREVE DHE TË MASËS SË SHPËRBLIMIT
PËR REZULTATE TË LARTA NË ARTIN SKENIK, TË ARRITURA NË KONKURRIME
NDËRKOMBËTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr.9631, datë 30.10.2006 “Për artin skenik”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin e autorëve, krijues dhe interpretues, të artit skenik, për rezultate të larta, të arritura në konkurrenca ndërkombëtare, në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë, me urdhër të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Ky shpërblim përfitohet nga autorët, krijues dhe interpretues, që kanë marrë çmim të parë në veprimtari të rëndësishme ndërkombëtare, pas paraqitjes së kërkesës me shkrim te Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

3. Kushtet dhe kriteret, që duhet të plotësojë autori, krijues apo interpretues, për përfitimin e shpërblimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi, janë:

a) Të ketë marrë pjesë në veprimtaritë më të rëndësishme evropiane dhe botërore, të njohura zyrtarisht nga Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe institucionet qendrore publike të artit skenik, në varësi të kësaj ministrie;

b) Pas një përzgjedhjeje serioze nga juritë ndërkombëtare të ketë fituar çmimin dhe të jetë i shpallur publikisht fitues nga organizatorët e veprimtarisë;

c) Çmimi të jetë i shoqëruar me diplomën apo certifikatën përkatëse, të noterizuar, dhe me dokumente të tjera zyrtare, si dhe me publikimet për jehonën e veprimtarisë, në median e shkruar të vendit, ku zhvillohet veprimtaria ndërkombëtare.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i

Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

5. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.494, datë 1.8.2007

PËR MIRATIMIN E NORMAVE TË TRAJTIMIT ME USHQIM TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, TË STUDENTËVE DHE KURSANTËVE NË SHKOLLAT E POLICISË DHE TË SHTETASVE TË NDALUAR, DERI NË SQARIMIN E POZITËS SË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 127 të ligjit nr.9749, datë 4.6.2007 “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Punonjësit e Policisë së Shtetit, studentët e kursantët, në shkollat e policisë, brenda vendit, dhe kursantët, që trajnohen në institucione të tjera të Policisë së Shtetit, të trajtohen me ushqim, pa pagesë.

Normat e ushqimit ditor përcaktohen dhe miratohen nga Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Shëndetësisë.

2. Trajtimin me ushqim, pa pagesë, sipas pikës 1 të këtij vendimi, e përfitojnë edhe:

a) shtetasit e huaj, që hyjnë ilegalisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, deri në sqarimin e pozitës së tyre;

b) shtetasit shqiptarë, të kthyer nga vendet e tjera, deri në sqarimin e pozitës së tyre;

c) shtetasit shqiptarë, të cilët qëndrojnë në mjediset e komisariateve, deri në dërgimin e tyre në mjediset e paraburgimit (të shoqëruar e të ndaluar).

3. Trajtimi me ushqim, sipas shkronjave “a”, “b” e “c”, të pikës 2, bëhet sipas normës së miratuar nga Ministri i Brendshëm dhe Ministri i Shëndetësisë.

4. Punonjësit e policisë, që përfitojnë të drejtën e trajtimit me ushqim për një vakt, “drekë”, në strukturat, që nuk kanë infrastrukturën e duhur për ushqim të gatuar, të kompensohen, për ditët efektive të punës, në vlerë (në lekë), sipas vlerës së racionit bazë ushqimor për vaktin e drekës, të miratuar nga Ministri i Brendshëm.

5. Ministri i Brendshëm, në bashkëpunim me Ministrin e Shëndetësisë, miraton normat e ushqimit ditor për çdo strukturë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

6. Ministri i Brendshëm miraton:

a) strukturat e Policisë së Shtetit, që përfitojnë ushqim me tri vakte a me një vakt;

b) normat e zëvendësimit të artikujve ushqimorë, brenda limitit të miratuar të k/kalorive, duke ruajtur raportin e njësive ushqimore;

c) normat e pajisjeve dhe të materialeve të shërbimit të ushqimit;

ç) kompensimin e ushqimit në vlerë (në lekë) për strukturat, që e përfitojnë të sipas shkronjës “b” të pikës 2 të këtij vendimi;

d) rastet e kompensimit në vlerë, kur, për shkak të detyrës, punonjësit e policisë dhe ata, që e përfitojnë ushqimin, sipas pikës 2, nuk mund të konsumojnë ushqim të gatuar.

7. Vendimet nr.160, datë 9.7.1975, nr.139, datë 27.4.1990, nr.439, datë 10.10.1992, nr.545, datë 29.12.1992, nr.341, datë 9.7.1993, nr.13, datë 24.1.1994, nr.402, datë 25.6.2004, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohen.

8. Në vendimin nr.505, datë 24.10.1994 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me ushqim të kuadrove ushtarake aktive, që shërbejnë në strukturat e ushtrisë”, të ndryshuar, fjalët “Ministrisë së Brendshme”, shfuqizohen.

9. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i

Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

10. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.1150, datë 16.7.2007

**PËR PROCEDURAT E ADMINISTRIMIT TË DONACIONEVE DHE FINANCIMIN
E PROJEKTEVE**

Në mbështetje të nenit 102 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr.166, datë 11.4.1997 “Për sigurimin dhe administrimin e ndihmave humanitare dhe të emergjencës”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Për të gjitha donacionet ku përfituese është Policia e Shtetit, donatori duhet të informoj Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Drejtori i Përgjithshëm i Policisë ngarkon Sektorin e Koordinimit të Projekteve, për administrimin e dokumentacionit, koordinimin dhe ndjekjen e procedurave deri në përfundim të tyre.

2. Donacioni duhet të jetë në përputhje me standardet dhe politikat e Policisë së Shtetit, në rast të kundërt me një notë falënderimi informohet donatori, për pamundësinë e përdorimit të objektit të dhuruar.

3. Sektori i Koordinimit të Projekteve është përgjegjës për koordinimin e të gjithë veprimtarisë që lidhet me donacionet.

4. Donatori, duhet të dorëzojë kontratën, ose letrën zyrtare të institucionit donator, ku përcaktohet objekti/objektet që do të dhurohen, specifikimet teknike, qëllimi i përdorimit dhe përfituesi, në rastet kur ai është i identifikuar etj. Asnjë përfitues nuk ka të drejtë të veprojë me iniciativë për pranimin e donacionit, pa zbatuar pikat 1- 4 të këtij udhëzimi.

5. Dokumentet që donatori duhet të dorëzojë, që lidhen me donacionin duhet të jenë në gjuhën shqipe, në rast se një gjë e tillë nuk realizohet, do të pranohen në gjuhën Angleze. Sektori i Koordinimit të Projekteve në bashkëpunim me sektorin e Koordinimit të Shërbimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, brenda 10 ditëve nga marrja e tyre, do të realizojnë përkthimin e gjithë dokumentacionit me përkthyes të autorizuar dhe të licencuar.

6. Donacionet me përfitues Policinë e Shtetit, ose strukturat e tjera të Ministrisë së Brendshme pranohen nga Qendra e Furnizimit Materialo Teknik i cili është i vetmi institucion i autorizuar për procedimin dhe administrimin e donacioneve me natyra të ndryshme, ose strukturat e tjera siç përcaktohet në pikën 15 të këtij udhëzimi.

7. Sektori i Koordinimit të Projekteve, mbi bazën e dokumentacionit të pikës 3 dhe 4, dhe pas konsultimeve me Drejtorinë e Programimit dhe Mbështetjes Logjistike dhe Drejtorisë së Teknologjisë dhe Menaxhimit të Informacionit i dërgon zyrtarisht QFMT, urdhrin e veprimi, ku i kërkon marrjen në dorëzim dhe administrim të dokumentacionit dhe objekteve të dhuruara.

8. Donatori shoqëron mallrat me aktin e dhurimit (notën e dorëzimit) në QFMT. QFMT krijon komisionin e pritjes së mallrave e mjeteve të dhuruara, të cilët në prezencë të donatorit, verifikojnë sasinë, pamjen e jashtme dhe atë fizike të objekteve të dhuruara. Komisioni i pritjes së objekteve të dhuruara harton procesverbalin e pritjes së donacionit. Një kopje e aktit të pranimit nënshkruhet nga magazinieri që merr në dorëzim objektin e dhuruar dhe i jepet donatorit.

9. Donatori duhet të shoqëroj objektin e dhuruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kontratën/aktin e dhurimit ose letrën zyrtare të institucionit donator;
- b) faturën që identifikon mallrat dhe vlerën e tyre;

- c) dokumentet e zhdoganimit;
- d) certifikatën e origjinës.

10. QFMT nëpërmjet komisionit të kolaudimit të donacioneve, të krijuar me punonjës të sektorit të kolaudimit të këtij institucioni, por dhe specialistë sipas fushës së përdorimit të donacionit, mbështetur në:

- a) dokumentacionin e dhurimit sipas pikave 7 - 9 të këtij udhëzimi;
- b) procesverbalin e pritjes së objekteve të dhuruara sipas pikës 8 të këtij udhëzimi;
- c) gjendjen teknike të objekteve të dhuruara dhe përputhjen e tyre sipas kontratës, ose letrës zyrtare ku janë specifikuar të dhënat teknike të objekteve të dhuruara.

Hartojnë procesverbalin e kolaudimit të objekteve të dhuruara, një kopje i të cilit i dërgohet Sektorit të Koordinimit të Projekteve, për donatorin.

11. Në raste se objektet e dhuruara janë pa çmime, QFMT vepron në këtë mënyrë:

- a) Krijon Komisionin e Vlerësimit të objektit/objekteve të dhuruara me jo më pak se tre persona, ku bën pjesë shefi i financës dhe dy specialistë të fushës së përdorimit të objektit të dhuruar.
- b) Komisioni në përputhje me dokumentacion e mësipërm dhe mbështetur në gjendjen e objekteve të ngjashme në magazinat e QFMT, organe e reparte të Policisë së Shtetit, tregun e shumicës në Tiranë, çmimit të INSTATIT, apo referuar çmimeve të referencës për mallrat e ngjashme në doganë, bën vlerësimin e objekteve të dhuruara në vlerë, duke hartuar procesverbalin përkatës.

c) Procesverbali i komisionit të vlerësimit miratohet nga drejtuesi i QFMT, dhe një kopje i dërgohet Sektorit të Koordinimit të Projekteve, për t'iu bërë e ditur donatorit.

d) Për objektet e dhuruara, por që janë të përdorura në rate se mungon viti i vënies në punë realizohet vlerësim teknik, sipas shkronjave a, b, c të pikës 11 të udhëzimit, duke i administruar si objekte të kategorisë së dytë.

12. Strukturat përfituese të donacionionit dhe Drejtoria e Teknologjisë dhe Menaxhimit të Informacionit janë të detyruar të vënë në dispozicion të QFMT, menjëherë specialistët që kërkohen për kolaudimin dhe vlerësimin e donacioneve.

13. Shpërndarja e pajisjeve bëhet nga QFMT, sipas urdhrin të shpërndarjes së Drejtorisë së Programimit dhe Mbështetjes Logjistike, ose Drejtorisë së Teknologjisë dhe Menaxhimit të Informacionit, sipas destinacionit të përcaktuar në kontratë, aktin e dhurimit, ose mbi bazën e kërkesës për tërheqjen e donacionit nga përfituesi.

14. Në rastet kur urdhri i shpërndarjes lëshohet sipas kërkesës për tërheqjen e donacionit, kjo e fundit duhet të përmbajë:

- a) qëllimin e përdorimit të objektit që dhurohet;
- b) përshkrimin e funksionit të pajisjes;
- c) vendin, personin, kohën e instalimit dhe vënies në punë;
- d) personin përgjegjës për përdorimin e donacionit;
- e) deklarin për mirëmbajtjen dhe administrimin.

Kërkesa nënshkruhet nga drejtuesi i strukturës që është përfitues i donacionit.

15. Me autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, ose zëvendës drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për Menaxhimin e Burimeve Ndihmëse e Mbështetjes, objektet e dhuruara mund të kalojnë direkt nga donatori te përfituesi, por duhet të zbatohen të gjitha procedurat e parashikuara në udhëzim, që nënkupton që rolin e QFMT e luan institucioni përfitues i donacionit.

16. Struktura përfituese është e detyruar që brenda një muaj nga marrja e donacionit të dërgojë:

- a) Në QFMT dokumentacionin e konfirmimit, sipas legjislacionit të qarkullimit të mallrave pa pagesë.
- b) Në Sektorin e Koordinimit të Projekteve informacion mbi vënien në punë dhe ecurinë e përdorimit të objektit të dhuruar i cili duhet të përmbajë:
 - funksionalitetin e objektit të dhuruar;
 - gjendjen fizike të objektit të dhuruar;
 - mirëmbajtjen dhe kostot përkatëse të mirëmbajtjes të parashikuara.

17. Informacioni për donacionet e përfituara nga strukturat vendore të Policisë së Shtetit dhe QFMT-ja, duhet të paraqitet në fund të çdo periudhe 6-mujore dhe vjetore në Sektorin e Koordinimit të Projekteve. Informacioni 6 mujor paraqitet brenda datës 5 korrik dhe informacioni vjetor, brenda datës 15 janar.

Sektori i Koordinimit të Projekteve dërgon informacion mbi donacionet e përfituara, brenda 5 ditëve nga afatet e mësipërme te Drejtoria e Programimit dhe Mbështetjes Logjistike dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë. Drejtoria e Programimit dhe Mbështetjes Logjistike përgatit informacionin për Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme.

18. Sektori i Koordinimit të Projekteve, mban Regjistrin e Donacioneve, ku çdo projekt, apo donacion e identifikon me një numër (kod), bën azhurnimin periodik të tyre dhe raportimin progresiv, minimalisht vjetor. Për projektet me financim të huaj paraqitet situacioni mujor dhe progresiv i cili i raportohet strukturave të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave.

19. Për projektet me financim të huaja në formën e ndihmave, apo kredive, zbatohen aktet normative dhe procedurat e mëposhtme:

a) Përcaktimi i prioritetëve të projekteve bëhet sipas pikës 1 dhe 2 të udhëzimit, dhe pas konfirmimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë, i paraqitet për miratim Ministrit të Brendshëm.

b) Miratohet projekti i zbatimit.

c) Nxirret akti normativ i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë për investimin që do të përfitohet nga projekti i huaj

d) Emërohet personi i kontaktik nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.

e) Realizohen procedurat e prokurimit sipas rregullave komunitare, ose sipas legjislacionit Shqiptar të prokurimit, ku Sektori i Koordinimit të Projekteve dhe Strukturat Mbështetëse të Policisë së Shtetit sigurojnë bashkëpunim të vazhdueshëm, duke vënë në dispozicion specialistë për realizimin e procedurave.

f) Hartohet kontrata e cila i vihet në dispozicion përfituesit në gjuhën shqipe, ose në se është e pamundur në gjuhën angleze dhe përkthehet nga përkthyes të licencuar dhe noterizohet nga Sektori i Koordinimit të Shërbimeve të Brendshme në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

g) Sektori i Koordinimit të Projekteve në bashkëpunim me personin e kontaktit harton raporte progresi të vazhdueshme për ecurinë e projektit dhe informon Drejtorin e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

h) Ndjekja, administrimi dhe raportimi i finacimeve të projekteve të huaja në formën e ndihmave, apo kredive bëhet mbështetur në udhëzimin nr.8, datë 17.02.2003 të Ministrisë së Financave “Për evidentimin, regjistrimin, përdorimin dhe raportimin e finacimeve të huaja në kuadrin e projekteve dhe marrëveshjeve me donatorët e huaj”.

i) Pritja, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e investimeve në formën e projekteve të huaja në ndihma, bëhet sipas këtij udhëzimi, ligjit nr.6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare” dhe vendimit të këshillit të ministrave nr.70, datë 11.3.1985 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”.

j) Strukturat e Mbështetjes Logjistike të Policisë së Shtetit janë të detyruara të planifikojnë fonde për mirëmbajtjen e aseteve, sipas pikës 17 të këtij udhëzimi.

20. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, strukturat vendore të Policisë së Shtetit dhe Akademia e Policisë.

21. Për ndjekjen e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohet: Zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit për Menaxhimin e Burimeve Ndihmës e Mbështetjes.

22. Urdhri i Ministrit të Brendshëm nr.561, date 30.9.1997 “Për vendosjen e çmimeve të materialeve e pajisjeve që i jepen ndihmë Ministrisë së Brendshme” dhe urdhri nr.1471, datë 31.5.2001 “Për procedurat që do të ndiqen për trajtimin e projekteve dhe ndihmave nga donatorët e huaj” i Ministrisë së Rendit Publik, dhe të gjitha aktet e tjera administrative që bien ndesh me këtë udhëzim, revokohen.

23. Ky udhëzim hynë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani

UDHËZIM
Nr.1151, datë 16.7.2007

**PËR KRITERET DHE PROCEDURAT E VLERËSIMIT DHE ASGJËSIMIT TË AKTIVEVE
TË QËNDRUESHME DHE QARKULLUESE NË SISTEMIN E MINISTRISË BRENDSHME**

Në mbështetje të nenit 102 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.70, datë 11.3.1985 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.170, datë 3.4.1993 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.70, datë 11.3.1985”,

UDHËZOJ:

1. Nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese në sistemin e Ministrisë së Brendshme të bëhet me miratim të:

- a) Ministrit të Brendshëm,
- b) Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit,
- c) Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimeve Mbështetëse,
- d) Komandantit të Gardës së Republikës,
- e) Drejtorit të Akademisë së Policisë,
- f) Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile,
- g) Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile,
- h) Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Qeverisjes Vendore,
- i) Departamentit të Administratës Publike,
- j) Drejtuesve të strukturave të Policisë së Shtetit dhe Institucioneve buxhetore të vartësisë të Ministrisë së Brendshme, që kanë bilanc më vete.

2. Procedura e vlerësimit dhe e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese kryhet në dy faza:

- a) Faza e parë: Procedura e vlerësimit (seleksionimit);
- b) Faza e dytë: Procedura e nxjerrjes jashtë përdorimit (asgjësimit).

3. Për të realizuar vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese, nxirret urdhri i brendshëm i titullarit ku përcaktohet:

- a) Përbërja e komisionit të vlerësimit dhe e komisionit të asgjësimit.

- Komisioni i vlerësimit të përbëhet nga jo më pak se 3 vetë. Në përbërje të komisionit të jenë drejtuesit e specialistët e sektorit të financës e logjistikës. Punonjësi me përgjegjësi materiale të jetë i pranishëm gjatë procesit të vlerësimit, por jo në përbërje të komisionit. Kryetari i Komisionit të Vlerësimit të jetë shefi i logjistikës ose shefi i financës.

- Komisioni i asgjësimit të përbëhet nga jo më pak se 5 veta, kryetari i këtij komisioni të jetë zëvendëstitullari i institucionit, në mungesë të tij, një nga drejtuesit kryesor të institucionit.

- Përgjashtimisht sa sipër, për vlerësimin dhe asgjësimin e mjeteve të transportit rrugor, komisionet e vlerësimit dhe të asgjësimit përbëhen nga jo më pak se 7 anëtarë dhe në përbërjen e tyre marrin pjesë detyrimisht dy specialistë të lartë të fushës (inxhinier mekanik). Kur këto specialistë të lartë nuk mund të sigurohen nga strukturat përkatëse, aktivizohen specialistë të jashtëm sipas procedurave ligjore.

- Komisionet e vlerësimit dhe komisionet e asgjësimit përgjigjen për zbatimin e ligjshmërisë dhe të kriterëve të miratuara për nxjerrjen jashtë përdorimit të vlerave materiale. Para fillimit të procesit të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese, me komisionet e vlerësimit dhe asgjësimit zhvillohen seminare për njohjen dhe zbatimin e ligjit nr.6942, datë 25.12.1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, ligjit nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin”, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.70, datë 11.3.1985 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave materiale e monetare”, vendimin e Këshillit të Ministrave nr.445, datë 25.12.1990 dhe vendimin e Këshillit të

Ministrave nr.170, datë 3.4.1993 “Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.70, datë 11.3.1985” dhe kërkesat e këtij udhëzimi.

a) Afatet e kryerjes së vlerësimit e të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese.

b) Afatet e përgatitjes së dokumentacionit (procesverbaleve) për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese, që janë në kompetencë të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Ministrit të Brendshëm dhe afati i dërgimit për miratim në strukturat e mësipërme.

4. Vlerësimi të kryhet gjatë muajit shtator-tetor, ndërsa asgjësimi i vlerave materiale të kryhet gjatë muajit nëntor të çdo viti ushtrimor. Për raste të veçanta kur paraqitet nevoja për vlerësim të mallrave që prishen e dëmtohen, vlerësimi dhe asgjësimi mund të bëhet dhe jashtë këtij afati.

5. Aktivët e qëndrueshme e qarkulluese që do të vlerësohen e nxirren jashtë përdorimit grumbullohen në magazinën qendrore të drejtorive, komisarivateve, reparteve e institucioneve të tjera, me dokumentacion të rregullt kundrejt plotësimit të fletëhyrjes e cila të ketë bashkëlidhur kopjen e fletëdaljes së dorëzuesit. Në rastet kur në magazinën qendrore grumbullohen makineri, pajisje apo mjete transporti, fletëdaljes së dorëzuesit t'i bashkëlidhet dokumentacioni justifikues teknik dhe argumentues.

6. Komisioni i vlerësimit (seleksionimit) të aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese, kontrollon një për një çdo artikull, përcakton drejt shkallën e konsumit, si dhe destinacionin e përdorimit për ripërtëritje, mbeturinë, shitje apo për asgjësim.

7. Në përfundim të procesit të vlerësimit (seleksionimit) komisioni përpilon në dy kopje procesverbalin e vlerësimit dhe ia paraqet për miratim drejtuesit të institucionit, brenda 5 ditëve nga data e përfundimit të procesit të vlerësimit.

8. Për aktivët e qëndrueshme e qarkulluese që janë në kompetencë të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe Ministrit të Brendshëm, procesverbali i nxjerrjes jashtë përdorimit plotësohet në 3 kopje, nga të cilat 2 kopje i dërgohen për miratim Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë dhe Ministrit të Brendshëm (në muajin tetor të çdo viti). Krahas procesverbalit pranë institucionit qendror dërgohen relacione të hollësishme për argumentimin tekniko-ekonomik të nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese.

9. Në Ministrinë e Brendshme, sipas kompetencës krijohet komisioni qendror i vlerësimit dhe sekretariati teknik për përgatitjen e dokumentacionit, ndërsa në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë krijohet komision vlerësimi, si më poshtë:

a) Në Ministrinë e Brendshme Komisioni Qendror i vlerësimit për nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese, që janë në kompetencë të Ministrit të Brendshëm të përbëhet nga:

- Sekretari i Përgjithshëm	Kryetar;
- Drejtori i Përgjithshëm i Policisë	Anëtar;
- Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse	Anëtar;
- Drejtori i Shërbimeve Juridike	Anëtar;
- Drejtori i Planifikimit Financiar	Anëtar;
- Zëvendëskomandanti i Gardës së Republikës	Anëtar.

Për përgatitjen e dokumentacionit do të shërbej Sekretaria Teknike e përbëre nga:

- Drejtori i Shërbimeve Brendshme;
- Drejtori i Drejtorisë së Programimit dhe Mbështetjes Logjistike;
- Drejtori i Menaxhimit të Teknologjisë dhe Informacionit;
- Kryetari i Degës së Mbështetjes Logjistike të Gardës së Republikës;
- Drejtori i Buxhet-Financës në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit;
- Specialist në Sektorin e Investimeve dhe Mirëmbajtjes së Pronës.

b) Për vlerësimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese, që janë në kompetencë të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, komisioni qendror krijohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë.

10. Komisionet qendrore administrojnë procesverbalet dhe relacionet shoqëruese të strukturave që i kanë paraqitur dhe:

- Kur i vlerësojnë të sakta i miratojnë brenda 10 ditëve nga pranimi i tyre dhe i dërgojnë për miratim përfundimtar te Ministri i Brendshëm, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Shtetit dhe strukturat e tjera sipas kompetencës të përcaktuar në këtë udhëzim.

- Kur e vlerësojnë të domosdoshme kanë të drejtë të kryejnë kontrole dhe verifikime të dokumentacionit të objektit që propozohet për tu nxjerrë jashtë përdorimit.

- Kur dokumentacioni dhe relacioni nuk janë të plotë mund ta kthejnë për plotësim brenda 15 ditëve nga paraqitja e tyre. Struktura propozuese është e detyruar të bëjë saktësimet e duhura brenda 5 ditëve.

Pas miratimit nga Ministri i Brendshëm, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë Shtetit dhe strukturat e tjera sipas kompetencës të përcaktuar në këtë udhëzim, vendimi i përcillet për vazhdim procedure brenda 5 ditëve nga miratimi, strukturës propozuese.

11. Procedura e asgjësimit të vlerave materiale fillon pasi të jetë miratuar procesverbali i vlerësimit. Procesi i asgjësimit fillon jo më vonë se 5 ditë nga data e miratimit të procesverbalit të vlerësimit.

12. Asgjësimi i vlerave materiale kryhet nga komisioni i asgjësimit i miratuar nga drejtuesi i institucionit. Kryetar i këtij komisioni të jetë zëvendëstitullari, në mungesë të tij, të jetë një nga drejtuesit kryesorë të policisë, ose institucionit përkatës, ndërsa shefi ose specialisti i shërbimit dhe përgjegjësi material të jenë të pranishëm gjatë gjithë procesit të asgjësimit, por jo në përbërje të komisionit. Personat që kanë qenë në përbërje të komisionit të vlerësimit nuk mund të jenë anëtarë të komisionit të asgjësimit.

13. Në rastet kur kryhet asgjësimi i municioneve, ndezësve unifikues, granatave të dorës, predhave të kalibrave të ndryshëm etj., në përbërje të komisionit detyrimisht të ketë specialistë të xhenios e armatimit, në mungesë të merren specialistë të kësaj fushe në repartet e ushtrisë.

14. Për vlerat materiale që janë dëmtuar nga përdoruesit, komisioni i vlerësimit kërkon procesverbalet e mbajtura me personat përgjegjës dhe në qoftë se këto procesverbale nuk janë mbajtur, mbështetur në dispozitat ligjore propozon masat disiplinore e administrative ndaj personelit drejtues e administrues.

15. Komisioni i asgjësimit për kryerjen e asgjësimit fillimisht:

a) Verifikon në sasi dhe në vlerë, vlerat materiale që janë pasqyruar në procesverbalin e vlerësimit (përzgjedhjes), për diferencat që konstatohen gjatë verifikimit, përpilon procesverbalet përkatëse. Komisioni i asgjësimit publikon në stendën e njoftimeve listën e aktiveve të qëndrueshme që do të asgjësohen, jo më vonë se 5 ditë nga dita e asgjësimit.

b) Kontrollon gjendjen fizike (teknike), si dhe afatet e përdorimit të çdo artikulli dhe nëse konstaton vlerësime jo të rregullta nga komisioni i vlerësimit, ndaj këtij të fundit mbahet procesverbal me masa konkrete dhe i paraqiten për miratim drejtuesit të institucionit.

c) Asgjësimi i vlerave materiale kryhet në prani të komisionit të asgjësimit, në përfundim mbahet procesverbali, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit dhe i paraqitet për miratim drejtuesit të institucionit. Për makineritë dhe mjetet e transportit që do të asgjësohen, procesverbalit të asgjësimit i bashkëngjiten dhe fotografitë dixhitale të tyre, në momentin e paraasgjësimit.

d) Procesverbalit të asgjësimit i bashkëlidhen kopja e fletëhyrjes për materialet e ndryshme të marra në ngarkim dhe fletëdalja për materialet e nxjerra jashtë përdorimit dhe të asgjësuar.

16. Kriteret e nxjerrjes jashtë përdorimit

a) Për pjesët e ndërrimit, instrumentet dhe veglat e punës:

- Aktivitetet e qëndrueshme të trupëzuara (pjesët e ndërrimit, instrumentet dhe veglat e punës) nxirren jashtë përdorimit, kur kanë plotësuar afatin e përdorimit e për shkak të amortizimit të tyre janë bërë të papërdorshme, kur riparimi është i pamundur si pasojë e konsumimit të tyre dhe nuk mund të përshtaten për ndonjë qëllim tjetër;

- Kur gjatë përdorimit, pjesët e ndërrimit, instrumentet dhe veglat e punës dëmtohen dhe është e pamundur të kthehen në gjendje pune nëpërmjet riparimit. Në rastet kur dëmtimi i tyre është për arsye subjektive, nxjerrja jashtë përdorimit kryhet pasi të jetë nxjerrë përgjegjësia materiale ndaj personave fajtorë;

- Vlera e riparimit ose përshtatjes është e barabartë ose më e madhe se vlera fillestare;

- Kur pjesët e këmbimit të çmontuara nga makineritë ose automjetet, nuk gjejnë përdorim dhe nuk mund të përdoren apo të përshtaten për makineritë e pajisjet e tjera.

b) Materialet, mallrat, objektet e inventarit të imët dhe ambalazhet nxirren jashtë përdorimit kur:

- Kanë plotësuar afatin e përdorimit dhe nuk mund të përdoren në formën që janë ose në një formë tjetër;

- Kanë humbur cilësitë e përcaktuara në standardet shtetërore dhe nuk mund të përdoren në formën që kanë ose në ndonjë formë tjetër pavarësisht nëse kanë mbushur afatin e përdorimit të tyre, kjo e konfirmuar nga analizat laboratorike;

- Janë dëmtuar e janë bërë të papërdorshme si pasojë e ndonjë fuqie madhore (tërmete, zjarre, përmbytje etj.);

- Është plotësuar koha (normative) e përdorimit ose janë dëmtuar dhe nuk mund të riparohen për tu rivendë në gjendje pune;

- Vlera e riparimit ose përshtatjes është e barabartë ose me e madhe se vlera fillestare.

c) Makineritë, pajisjet, armatimi e municioni nxirren jashtë përdorimit kur:

- Është plotësuar koha e shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit të miratuara dhe që për shkak të konsumit moral e fizik të tyre janë bërë të papërdorshme dhe riparimi i tyre është pa leverdi ekonomike;

- Për shkak të ndryshimit të procesit teknologjik ose ndryshimit strukturor, nuk janë gjetur mundësitë e përdorimit për qëllimin e caktuar ose për qëllime të tjera ashtu siç janë ose dhe me përshtatje, si dhe kur nuk ka mundësi për përdorimin e tyre brenda e jashtë sistemit të Ministrisë Brendshme;

- Shuma e shpenzimeve për riparimin e përgjithshëm të fundit dhe shumën e shpenzimeve plotësuese jo normale të bëra gjatë vitit të fundit të shfrytëzimit, për efekt të vjetërimit të makinës është më e mëdha se vlera kontabël bruto (vlera fillestare), kur si pasojë e avarisë është dëmtuar në atë shkallë sa është e pamundur që të kthehet në gjendje pune;

- Municionet e të gjitha llojeve nxirren jashtë përdorimit kur paraqesin rrezikshmëri në ruajtje (municione të shkrehura, të dëmtuara);

- Ndezëset unifikues, fishekët shenjdhënës, granatat e dorës, predhat e artilerisë, topave mortajave, granatahdhëseve në rastet kur nuk plasin gjatë qitjeve.

d) Dokumentet me vlerë, si dhe formularët e ruajtjes së rreptë nxirren jashtë përdorimit në rastet kur:

- Me akte normative bëhen ndryshime të përmbajtjes dhe formës së dokumenteve në mënyrë dhe që nuk mund të përdoren më tej;

- Ka defekte në prodhim dhe që nuk mund të vihen në përdorim, pasi të jetë nxjerrë më parë përgjegjësia;

- Janë plotësuar gabim për arsye objektive (gabime jo për faj të punonjësit);

- Janë plotësuar gabim për arsye subjektive, në këto raste nxirret përgjegjësia dhe merret masa e zhdëmtimit në ngarkim të personave fajtorë. Zhdëmtimi të kryhet me vlerën e emetimit të dokumentit me vlerë (pa taksën);

Për llojin e dokumentit me vlerë apo formularin e ruajtjes së rreptë të hequr nga përdorimi të evidentohet sasia, seria, vlera, si edhe akti normativ përkatës që ka miratuar heqjen nga përdorimi të dokumentit me vlerë.

17. Trajtimi i mëtejshëm i pajisjeve dhe materialeve të miratuara për jashtë përdorimit të bëhet si më poshtë:

Pjesët e ndërrimit, instrumentet dhe veglat e punës administrohen në skrap sipas llojit të tyre. Ambalazhet, inventari i imët, materialet dhe mallrat, kur nuk mund të shfrytëzohen për qëllime të tjera, transformohen, administrohen dhe përdoren si mbeturinë ose asgjësohen (groposen, digjen etj.), në rastet kur janë të dëmshme për shëndetin dhe ambientin. Pajisjet dhe makineritë zërthehen në nyje dhe agregate dhe materialet e përfutuara klasifikohen dhe administrohen në tre grupe: të mira që përdoren më tej, që mund të përdoren nëpërmjet riparimit ose përshtatjes dhe të papërdorshme (skrap).

18. Të gjithë vlerat materiale që nxirren jashtë përdorimit të shkarkohen me çmimin e regjistruar në librat e llogarisë materiale të institucioneve buxhetore.

19. Mbeturinat e përfutuara nga nxjerrja jashtë përdorimit e materialeve administrohen në llogari të veçantë të vlerësuar me çmimin e tregut. Çmimet vendosen me komision, të krijuar për çdo rast me urdhër të titullarit.

20. Kompetenca për miratimin e aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese për nxjerrje jashtë përdorimi për Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Ministrin e Brendshëm, është si më poshtë:

20.1 Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit miraton nxjerrjen jashtë përdorimit, të aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese që disponon Policia e Shtetit, si më poshtë:

- Për makinerit e pajisjet, veglat dhe instrumentet e mirëmbajtjes:
Gjeneratorët elektrikë mbi 10 Kw, dhomat frigoriferike, motopompat, autoofiçinat dhe pajisje e makineri të ofiçinave riparuese.

- Për armatimin dhe municionet:

Armatim mësimor, municion mësimor, instrumentet optike (dylbi të ndryshme dite dhe nate, busulla të ndryshme, steriogyp artilerie), shënjestrat optike, instrumentet optike mësimore, pajisjet speciale si: jelek antiplumb, xhaketa antiplumb, pllaka antiplumb, kaska antiplumb, mburoja policie, skafandra policie, megafon, aparatura të ndryshme, instrumentet dhe veglat e punës.

- Për materialet e shëndetësisë:

Aparaturat mjekësore dhe laboratorët mjekësor.

- Për materialet e xhenios:

Kostum antiminë dhe minakërkuesit.

- Për materialet e stërvitjes:

Aparatet elektronike për stërvitje me vlere mbi 50.000 lekë dhe poligone qitjeje.

- Për materialet e kimisë:

Moto degazuese FHL, aparat rrezematës, radiometër dhe rëntgenometër.

- Për materialet dhe pajisjet e informacionit:

Kamera filmimi, aparate fotografike dixhitale, laboratorë fotografikë, sistemet e komunikimit me radio dhe radio-rele, sistemet e vëzhgimi me radarë e kamera, pajisje ripertitore e radiobaze, pajisje vëzhgimi dixhitale, kamera dixhitale, centrale automatikë dixhitalë, instrumente matës (kombinat), pajisje radari, pajisje serveri, sisteme me kamera.

20.2 Ministri i Brendshëm miraton nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese të mëposhtme:

- Për mjetet e transportit:

Kamion mbi 10 tonë, automjete të të gjitha llojeve kur ato janë të blinduara, me zinxhir ose për përdorim të veçantë dhe autobusë me mbi 9 vende.

- Për armatim municionet:

Armët luftarake të të gjitha llojeve dhe armët speciale të të gjitha llojeve.

- Të tjera:

Sistemet informatike, mjetet detare dhe mjetet ajrore.

20.3 Për të gjitha aktivet e qëndrueshme dhe qarkulluese që nuk përfshihen në pikat 20.1 dhe 20.2 kompetencën e vlerësimit dhe asgjësimit e kanë strukturat dhe institucionet me bilanc më vete.

21. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen strukturat dhe institucionet me bilanc më vete të Ministrisë Brendshme.

22. Për ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të këtij udhëzimi ngarkohen: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Planifikimit Financiar, Garda e Republikës, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Qeverisjes Vendore, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, Departamenti i Administratës Publike dhe për auditimin e zbatimit të procedurave, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm.

23. Udhëzimi i Ministrit të Rendit Publik nr.245, datë 26.7.1994 "Për nxjerrjen jashtë përdorimit të vlerave materiale në komisariatet, institucionet e repartet e Ministrisë së Rendit Publik", udhëzimi i Ministrit të Brendshëm nr.1443, datë 25.8.2006 "Për një ndryshim në udhëzimin i Ministrit të Rendit Publik nr.245, datë 26.7.1994 "Për nxjerrjen jashtë përdorimit të vlerave materiale në komisariatet, institucionet e repartet e Ministrisë së Rendit Publik", si dhe çdo akt tjetër nënligjor që bie ndesh me këtë udhëzim, revokohen.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSSHËM
Bujar Nishani

MIRATOHET

PROCESVERBAL

Nr. _____ Datë _____

PËR SELEKSIONIMIN E VLERAVE DHE NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMIT TË VLERAVE MATERIALE NË SHËRBIMIN _____

Me urdhër të Drejtorit Nr. _____ komisioni pas një kontrolli në për një materialet e grumbulluara në magazinën e _____
për shërbimin _____ duke rivlerësuar në bazë të kriterëve të caktuara në urdhrin e MRP nr.245, datë 28.7.1994

Vendosi të seleksionojë e të nxjerrë jashtë përdorimit këto vlera materiale:

	EMËRTIMI I MALLIT	Nj/m	Koha e vënies në përdorim koha (muaj,viti)	Sasia gjithsej e grumbulluar	Mbeten për përdorim të mëtejshëm	NGA SASIA GJITHSEJ					
						Sasi a	Çmimi	Vlefta	Shkaqet e nxjerrjes jashtë përdorimit	Nga këto për:	
										Për riparim mirëmbajtje	Asgjësimit
1	b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9
2											
3											
4											
5											
6											
7											
8											
9											
10											
11											
12											
13											
14											

KOMISIONI I SELEKSIONIMIT DHE NXJERRJES JASHTË PËRDORIMIT

Kryetari

Anëtar

Anëtar

Përgjegjësi material

Miratohet

Procesverbal
Nr. _____ Datë _____

Për shndërrimin dhe asgjësimin e vlerave materiale në shërbimin

Në mbështetje të procesverbalit të vlerësimit Nr. _____ datë _____ të miratuar, komisioni i nxjerrjes jashtë përdorimit (asgjësimit), pasi kontrolloi një për një materialet e shqyrtuara nga komisioni i vlerësimit, në prani të përgjegjës të shërbimit z.Hektor Allajbej dhe përgjegjës material vendosi:
Të nxjerrë jashtë përdorimit këto materiale:

	EMËRTIMI I MATERIALIT	Nj/m	Sasia e materialeve		Çmimi	Vlera e materialeve		NGA SASIA GJITHSEJ E MATERIALEVE					
								Shndërrohen e riparohen			Asgjësohen		
			Me afat përdorimi	Pa afat përdorimi		Me afat përdorimi	Pa afat përdorimi	Dorëzohen (shiten)	Për pastrim	Për riparim	Për shitje	Digjen	Groposen
	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14
1													
2													
3													
4													
5													
6													
7													
8													
9													
10													
11													
12													
13													
14													

KOMISIONI I SELEKSIONIMIT DHE NXJERRJES JASHTË PËRDORIMIT

Kryetari

Anëtar

Anëtar

Përgjegjës material

UDHËZIM
Nr.548, datë 2.8.2007

PËR SHOQËRITË ANONIME “NË LIKUIDIM E SIPËR”, ME KAPITAL TËRËSISHT SHTETËROR

Në zbatim të nenit 102 pika 4 e Kushtetutës, ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare” seksioni i V “Likuidimi”, ligji nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë,

UDHËZON:

1. Me hyrjen në fuqi të vendimit të shpalljes në likuidim të shoqërisë anonime, procedurat e likuidimit do të bëhen në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, Kreu VI “Dispozita të përbashkëta për të gjitha format e shoqërive”, Seksioni V “Likuidimi”.

2. Shoqëria është në likuidim nga momenti i daljes së urdhrit të zotëruesit të vetëm të kapitalit të shoqërisë. Operacionet e likuidimit kryhen nga likuidatori, i cili përfaqëson shoqërinë dhe ka për objekt mbylljen e llogarive dhe çregjistrimin e shoqërisë nga Regjistri Tregtar me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

3. Me kalimin e shoqërisë në likuidim hartohet bilanci i likuidimit, i cili verifikohet dhe vërtetohet nga eksperti kontabël i autorizuar. Bilanci për efekt likuidimi miratohet nga Ministri i Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës dhe shërben si pikënisje për identifikimin e aseteve, elemente të pasurisë që do të likuidohen.

4. Me shpalljen e shoqërisë në likuidim, pasuritë të luajtshme dhe të paluajtshme shiten nga likuidatori i shoqërisë nëpërmjet ankandit duke përdorur publikimin. Njoftimi për shitje bëhet në buletin zyrtar 4 herë brenda 21 ditëve nga data e dërgimit të njoftimit për shitje. Njoftimi për shitje të vendoset edhe në ambientet e shoqërisë, si dhe në objektin që do të shitet. Njoftimi do të bëhet nga ana e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si dhe dokumentet do të blihen në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

5. Ankandet për shitjen e pasurive të shoqërive tregtare shtetërore në likuidim e sipër do të bëhen në ambientet e Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

6. Komisioni i ankandit do të jetë i përbërë nga jo më pak se 3 veta. Në çdo ankand për shitjen e pronës, pjesë e komisionit të tij do të jetë përfaqësuesi i Ministrisë (METE) si përfaqësues i pronarit shtet. Likuidatori nuk do të jetë kryetar i komisionit të ankandit.

7. Hartimi i procesverbalit të ankandit të evidentojë komisionin e ankandit, konkurruesit në ankand dhe shpalljen e fituesit (sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.704, datë 11.10.2006, kapitulli III). Kontrata e shitjes së objektit lidhet me pagesën e plotë të vlerës së objektit duke përfshirë dhe TVSH (20%) për asetet që janë objekt i saj (bazuar në ligjin nr.7928, datë 27.4.1995 për TVSH). Kontrata duhet të parashikojë qartë detyrimet e palëve dhe pagimin e taksave. Me lidhjen e kontratës likuidatori bën dorëzimin e objektit nëpërmjet aktit të dorëzimit.

8. Pas çdo ankandi të raportohet në Ministrinë e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës si përfaqësuese e pronarit të pronës shtetërore mbi realizimin e tij. Raporti të shoqërohet me dokumentacionin përkatës.

9. Vlera fillestare e ankandit për shitjen e objekteve dhe truallit të jetë vlera e përcaktuar nga ekspertë vlerësues të emëruar nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës me kërkesën e likuidatorit të shoqërisë. Ekspertët vlerësues do t'i referohen çmimeve të tregut. Kësaj vlere i shtohet vlera sipas kontabilitetit e inventarit ekonomik dhe vlera e mjeteve të xhiros së objektit përkatës.

10. Likuidatori ngre një komision për vlerësimin e mjeteve të xhiros si më poshtë:

a) Grupi “a” artikujt, që kanë vlera tregtimi me qarkullim normal, vlerësohen me çmimet e shitjes me shumicë në tregun aktual.

b) Artikujt që kanë vlerë tregtimi por me qarkullim të ngadalshëm, vlerësohen me vlerën kontabël të mbetur.

c) Grupi “c” artikujt, që nuk gjejnë treg shitje, vlerësohen me vlerën kontabël të kohës kur

kanë hyrë në magazinë shumëzuar me koeficientin 0.1.

d) Për makineri, pajisje dhe inventar stok që nuk kanë mundur të shiten sipas kërkesave të mësipërme, të zbatohen procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimit sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.70, datë 11.3.1985 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave monetare”, i ndryshuar.

e) Për metalet me ngjyra si bakri, alumini, plumbi, zinku, kallaji, nikeli, ari dhe argjendi, vlera fillestare e ankandit për rastet kur çmimi në treg është më i lartë se vlera kontabël e tyre në bilanc, do të llogaritet referuar çmimit të bursës së Londrës (LME). Në rast se nuk realizohet shitja me vlerën e llogaritur sipas LME-së, shoqëria cakton vlera të reja deri në vlerën kontabël të mallit.

11. Vlerësimi i bërë nga ekspertët vlerësues për të gjitha elementet e aktivitetit të përcaktuara më sipër para publikimit miratohet nga Ministri i Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës.

12. Para publikimit të objektit për shitje, shoqëria kërkon në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, hartën treguese përkatëse.

13. Në rast se nuk realizohet shitja me vlerat e përcaktuara nga ekspertët vlerësues, atëherë objekti të publikohet me vlerën sipas kontabilitetit dhe kësaj vlere t’i shtohet vlera e truallit të përcaktuar nga ekspertët vlerësues si më lart, si dhe 50% e vlerës së inventarit ekonomik dhe mjeteve të xhiros të përcaktuara si më sipër. Nëse edhe me vlerë kontabiliteti nuk shitet, atëherë do të vendosë Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

14. Të ardhurat e realizuara nga likuidimi si: shitja e aseteve, arkëtimi i debitorëve, të ardhurat nga qiraja, si dhe fitime të tjera do të shërbejnë për shlyerjen e kreditorëve të shoqërisë në likuidim e sipër në mënyrë proporcionale në varësi të mjeteve monetare të siguruara. Përfshihen nga ky rregull detyrimet fiskale dhe ato sociale (paga dhe sigurime shoqërore), të cilat do të shlyhen tërësisht. Për kërkesat debitorë që rezultojnë të paarkëtueshme, kur debitorët nuk ekzistojnë, kur kërkesat nuk janë të dokumentuara apo është humbur procesi gjyqësor etj., të procedohet duke i kaluar si shpenzime të likuidimit.

15. Likuidatori nuk mund të lidhë kontrata dhe nuk mund të shesë me mirëkuptim, pa autorizim nga Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

16. Në publikimin për shitje të pasurisë së shoqërisë në likuidim do të përfshihen edhe objektet e dhëna me qira, përpara datës së shpalljes së shoqërisë në likuidim.

17. Llogaritë vjetore depozitohen në formën dhe në afatet e zakonshme të parashikuara nga ligji nr.7661, datë 19.1.1993 “Për kontabilitetin”.

18. Likuidatori do të raportojë për çdo shtetje të kryer dhe do të informojë çdo 3 muaj duke dhënë llogari mbi ecurinë e operacioneve të likuidimit dhe kohën e nevojshme për përfundimin e tyre. Kur operacionet e likuidimit kanë përfunduar, likuidatori harton bilancin financiar përfundimtar të likuidimit, i cili do të shoqërohet me raportin e ekspertit kontabël të autorizuar për vërtetimin e llogarive përfundimtare të likuidimit. Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës vendos për llogaritë përfundimtare të likuidimit. Ai ngarkon likuidatorin për depozitim të llogarive pranë Regjistrimit Tregtar të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe marrjen e vendimit për mbylljen e likuidimit dhe çregjistrimin e shoqërisë.

19. Anulohen të gjitha miratimet e privatizimit të aseteve të përfshira në kapitalin e shoqërisë që nuk kanë filluar procedurën e përgatitjes së dokumentacionit para datës së shpalljes së shoqërisë në likuidim me vendim gjyqi.

20. Procedurat e shitjes për të gjitha asetet që janë publikuar para daljes së këtij udhëzimi, do të bëhen sipas këtij udhëzimi ndërsa për asetet e publikuara dhe që nuk janë shitur të zbatohet pika e udhëzimit nr.185, datë 26.3.2007 “Për shoqëritë anonime në likuidim e sipër, me kapital tërësisht shtetëror”.

21. Udhëzimi nr.185, datë 26.3.2007 “Për shoqëritë anonime në likuidim e sipër, me kapital tërësisht shtetëror” i Ministrisë së Ekonomisë, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
Genc Ruli

UDHËZIM
Nr.16, datë 3.8.2007

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.994, DATË 12.3.2003 “PËR ORGANIZIMIN
DHE FUNKSIONIMIN E AUTOSHKOLLAVE”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 119, 121 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr.994, datë 13.3.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e autoshkollave”, në nenin 5, bëhen ndryshimet si më poshtë:

- Në pikën 1, shprehja “Një autoshkollë për 10 000 banorë”, bëhet “Një autoshkollë për 5 000 banorë”.
 - Në pikën 2 “...por jo më pak se 5000 banorë...”, bëhet “...por jo më pak se 3000 banorë...”.
- Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

URDHËR
Nr.69, datë 17.7.2007

**PËR PRODHIMIN, EMETIMIN, ADMINISTRIMIN DHE SHITJEN E POLICËS KUFITARE
TË SIGURIMIT**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe nr.295, datë 15.9.1992 “Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj personave të tretë“, miratuar me ndryshime me ligjin nr.7641, datë 1.12.1992, me qëllim ruajtjen e forcimin e stabilitetit të tregut në produktin e sigurimeve kufitare të mjeteve motorike dhe për të mos cenuar konkurrencën në shërbimin e shitjes së policave të sigurimit për mjetet motorike me targë regjistrimi të huaj, me rekomandim të Autoritetit të Konkurrencës,

URDHËROJ:

1. Prodhimi, emetimi dhe administrimi i policave kufitare të sigurimit të bëhet nga Byroja Shqiptare e Sigurimit.
2. Forma e policës kufitare të sigurimit të jetë në përputhje me urdhrin datë 5.7.2002 të Ministrit të Financave “Për emetimin e policave të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta”, i ndryshuar.
3. Shoqëritë e Sigurimit, të shesin policat kufitare të sigurimit në sportelet e veta apo nëpërmjet agjentëve të licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, që veprojnë në pikat e kalimit kufitar të Shqipërisë dhe në pika të tjera të brendshme, njësoj si policat e sigurimit TPL e brendshme.
4. Shitja e policave kufitare të sigurimit të bëhet në përputhje me rregullat e përcaktuara për plotësimin korrekt të tyre dhe duke respektuar primet e pastra dhe shpenzimet administrative minimale të përcaktuara nga Ministri i Financave në zbatim të ligjit.
5. Shitja e policave kufitare të sigurimit të realizohet në mënyrë on-line.
6. Shoqëritë e sigurimit të përballojnë pagesën e dëmeve të shkaktuara në Shqipëri nga mjetet motorike të huaja të siguruara prej tyre me polica kufitare sigurimi.
7. Prodhimi, emetimi, administrimi dhe shitja e policave kufitare të sigurimit është objekt i mbikëqyrjes nga ana e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

8. Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri, të gjitha policat kufitare të sigurimit gjendje të paplotësuar t'i kthehen Byrosë Shqiptare të Sigurimit, me inventar të rregullt.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Byroja Shqiptare e Sigurimit dhe shoqëritë e sigurimit që do të ushtrojnë veprimtarinë e sigurimit të mjeteve motorike me targa të huaja regjistrimi.

10. Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri, shfuqizohet urdhri nr.14, datë 6.5.2005 i Ministrit të Financave "Mbi shitjen dhe administrimin e policës kufitare të sigurimit nga Byroja Shqiptare e Sigurimit", me ndryshimet, si dhe çdo urdhër tjetër i nxjerrë në zbatim të tij.

11. Ky urdhër botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 tetor 2007.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

URDHËR
Nr.70, datë 20.7.2007

**PËR MIRATIMIN E PRIMIT TË PASTËR TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË
MBAJTËSVE TË MJETEVE MOTORIKE PËR PËRGJEGJËSINË NDAJ PALËVE TË
TRETA**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 16 të ligjit nr.7641, datë 1.12.1992 "Për miratimin me ndryshime të dekretit nr.295, datë 15.9.1992 "Për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta", i ndryshuar, të rregullores së datës 7.5.2002 "Për disa shtesa në rregulloren nr.622/1, datë 15.12.1992 "Për zbatimin e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta", të nenit 100 të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 "Për veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime", me propozim të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare

URDHËROJ:

1. Tarifat minimale të primit të pastër të sigurimit të detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta për kontratat TPL e brendshme, me afat njëvjeçar, të jenë si më poshtë:

Në lekë

Kat	Klasa	Tipi	Kapaciteti motorik (cm ³) ose pesha bartëse (ton) ose numri i vendeve	Primi i pastër minimal
A1		Motoçikleta	Kapacitet motorik	
	A1/1		Deri në 150 cm ³	3.000
	A1/2		Mbi 150 cm ³	5.000
B1		Autovetura	Kapaciteti motorik	
	B1/1		Deri në 1200 cm ³	5.500
	B1/2		Mbi 1200 deri në 1800 cm ³	7.500
	B1/3		Mbi 1800 deri në 2500 cm ³	9.600
	B1/4		Mbi 2500 cm ³	11.000

Kat	Klasa	Tipi	Kapaciteti motorik (cm ³) ose pesha bartëse (ton) ose numri i vendeve	Primi i pastër minimal
B2		Furgona, mikrobusë	Nr.vendeve	
	B2/1		Nga 5 deri në 8 vende	13 000
	B2/2		Mbi 8 deri në 15 vende	18 000
C1		Autobusë	Mbi 15 vende	25 000
D1		Kamionçina	Pesha mbajtëse (ton)	
	D1/1		Deri në 1 ton	12 000
	D1/2		Mbi 1 deri 2 tonë	15 000
D2		Kamionë	Pesha mbajtëse (ton)	
	D2/1		Mbi 2 deri në 5 tonë	17 000
	D2/2		Mbi 5 deri në 10 tonë	19 000
	D2/3		Mbi 10 deri në 15 tonë	21 000
	D2/4		Mbi 15 tonë	25 000
E1		Rimorkio	Pesha mbajtëse (ton)	
	E1/1		Deri 1 ton	3 000
	E1/2		Mbi 1 ton	5 000
F		Mjetet bujqësore		3 000
G		Zjarrfikëse		10 000

2. Tarifa e primit të pastër të sigurimit të detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta për kontratat kufitare të sigurimit të jenë si më poshtë:

Kat	Tipi i mjetit	Primi në euro					
		15 ditore	20 ditore	25 ditore	30 ditore	45 ditore	Një vjeçare
A	Autovetura	17	21	24	28	31	150
B.1	Motoçikleta	8	10	12	14	17	60
B.2	Motokarro	10	14	17	21	24	75
C.1	Kamionë për mallra nga 15 deri 34.99 Kv	56	70	84	91	105	240
C2	Kamionë për mallra nga 35 Kv e lart	70	84	91	105	126	400
D	Ciklomotor	8	10	12	14	17	60
E	Autobusë	98	112	133	147	174	400
F1	Rimorkio kamioni	42	49	56	63	77	100
F2	Rimorkio autobusi	56	63	70	77	98	150
F3	Rimorkio të tjera	21	28	35	42	49	100

3. Shpenzimet administrative që i shtohen primit të pastër për sigurimin e detyrueshëm për mbajtësit e mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta për kontratat TPL e brendshme dhe për kontratat kufitare të sigurimit nuk mund të jenë më pak se 20% e primit të pastër.

4. Primi minimal i arkëtuar nga shoqëritë e sigurimit për kontratat e sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësitë ndaj palëve të treta është i barabartë me primin e pastër plus shpenzimet administrative minimale sipas pikës 3 të këtij urdhri.

5. Moszbatimi i tarifave të primeve, të përcaktuara në këtë urdhër, i bën shoqëritë e sigurimit subjekt të sanksioneve të përcaktuara në nenin 165 e vijues të ligjit nr.9267, datë 29.7.2004 “Për 3183

veprimtaritë e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime”, i ndryshuar.

6. Ngarkohen shoqëritë e sigurimit dhe Byroja Shqiptare e Sigurimit për zbatimin e këtij urdhri, i cili është subjekt mbikëqyrjeje nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

7. Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri, shfuqizohet urdhri i Ministrit të Financave nr.12, datë 18.4.2006 “Për miratimin e primit të pastër të sigurimit të detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta” dhe të çdo akti tjetër i dalë në zbatim të tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe i fillon efektet nga data 15.8.2007.

MINISTRI I FINANCEVE

Ridvan Bode

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË	
2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR	
3. REGJISTRAT E NOTERISË	
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:	
i. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....	1300
ii. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
iii. PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
iv. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR.....	800
v. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET.....	500
vi. PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
vii. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE.....	500

TREGUES LEGJISLACIONI

1 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
2 TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
3 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I).....	1000
4 TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500

Hyri në shtyp më 10.8.2007
Doli nga shtypi më 14.8.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Nënë Tereza"
Tiranë, 2007

Çmimi 44 lekë